



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 171

Tiranë – E enjte, 1 tetor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 22.9.2015	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës.....	11827
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 22.9.2015	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Serbisë dhe anëtarëve të tjerë të Nismës për Reformën Arsimore të Evropës Juglindore (ERI SEE), për selinë e sekretariatit të ERI SEE	11829
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 22.9.2015	Për shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër) dhe miratimin e rregullores së administrimit.....	11837
Urdhër i ministrit të Financave nr. 62, datë 17.9.2015	Për shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve dhe zbatimin e detyrueshëm të tij.....	11840
Vendim i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2, datë 27.7.2015	Për miratimin e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve...	11841
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 59, datë 14.9.2015	Për planin e ndihmës shtetërore për rindërtimin e stadiumit “Loro Boriçi” Shkodër.....	11855



VENDIM
Nr. 781, datë 22.9.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, PËR
BASHKËPUNIM NË FUSHËN E
ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË PËR BASHKËPUNIM NË
FUSHËN E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në vijim “Palët Kontraktuese”);

duke synuar të përforcojnë marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet dy shteteve;

të udhëbequr nga vullneti dhe dëshira për të pasur bashkëpunim produktiv të ndërsjellë në fushën e arsimit dhe të shkencës;

të vendosur që të mbështesin parimet e Aktit Final të Konferencës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (Akti i Helsinkit i vitit 1975), të Dokumentit të Parisit për Evropën e Re, të Konventës Evropiane Kulturore, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, të Konventës së Përgjithshme

për të drejtat e njeriut, të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, të Konventës Ndërkombëtare për njohjen e kualifikimeve të larta arsimore në Lisbonë 1997, të Paktit Ndërkombëtar për të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore, si dhe të Konventës për të drejtat e fëmijëve;

të bindur se bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e arsimit dhe shkencës do të përforcojë dhe thellojë marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve dhe do të forcojë miqësinë dhe mirëkuptimin ndërmjet dy popujve;

Bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese, në frymën e marrëdhënieve miqësore, do të zhvillojnë dhe ndihmojnë bashkëpunimin arsimor-shkencor ndërmjet institucioneve qendrore përgjegjëse për arsimin dhe shkencën të dy vendeve në bazë të parimeve të sovranitetit, pavarësisë, barazisë dhe reciprocitetit, duke përfshirë këtu edhe reciprocitetin financiar.

Neni 2

Në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të nxisin dhe ndihmojnë lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis institucioneve arsimore e shkencore të të dy vendeve.

Në këtë kuptim, Palët Kontraktuese do të nxisin:

1. bashkëpunimin në fusha të ndryshme shkencore, në shkenca matematiko-natyrore, teknike, bio-teknike, mjekësore, shoqërore / humane përfshirë edhe shkëmbimin e ekspertëve dhe punonjësve shkencorë;

2. nisma për projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore, rajonale dhe ndërkombëtare;

3. organizimin dhe pjesëmarrjen në simpoziume të përbashkëta, kongrese shkencore, konferenca, seminare, shkolla verore etj.;

4. ofrimin e bursave për studime pasuniversitare dhe ato të doktoratës në bazë të reciprocitetit dhe në fusha me interes të ndërsjellë, zhvillimin e mëtejshëm të stafit akademik;

5. shkëmbimin e informacioneve, publikimin e dokumentacioneve shkencore, të hartuara bashkërisht nga palët, si dhe shpalljen e rezultateve të hulumtimeve shkencore;



6. shkëmbimin e përvojave, materialeve informative dhe didaktike në fushën e planifikimit dhe administrimit të sistemit arsimor;

7. Republika e Shqipërisë do të mbështesë të gjitha iniciativat për ofrimin e mësimin të gjuhës maqedonase, në përputhje me kuadrin ligjor të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

8. shkëmbimin e literaturës dhe teksteve, materialeve dhe programeve arsimore, shkëmbimin e stafit pedagogjik midis institucioneve përkatëse arsimore;

9. Palët do të nxisin:

- kualifikimin e ndërsjellë të mësuesve që japin mësim në gjuhën shqipe në Maqedoni dhe të mësuesve që japin mësim në gjuhën maqedonase në Shqipëri, përkatësisht në Shqipëri dhe Maqedoni;

- shkëmbimin e përvojave për përgatitjen e teksteve mësimore cilësore në gjuhët amtare;

10. të gjitha format tjera të bashkëpunimit, për të cilat do të bien dakord Palët Kontraktuese.

Neni 3

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë dhe institucioneve arsimore në Republikën e Maqedonisë. Palët do të kujdesen të sigurojnë kushtet e nevojshme për arsimimin e pakicave kombëtare në gjuhën amtare në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Neni 4

Palët Kontraktuese angazhohen të lehtësojnë procedurat e njohjes së ndërsjellë të dëftesave, diplomave të arsimit fillor dhe të mesëm në Republikën e Maqedonisë dhe dëftesave, diplomave të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacioneve të vendeve përkatëse.

Palët Kontraktuese angazhohen të lehtësojnë procedurat e njohjes së ndërsjellë të diplomave, titujve, gradave dhe kualifikimeve profesionale, të lëshuara nga institucione arsimore të njohura zyrtarisht në të dyja vendet, në përputhje me kuadrin ligjor të vendeve përkatëse edhe standardet ndërkombëtare, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera të veçanta, për të cilat Palët bien dakord.

Faqe | 11828

Palët angazhohen të hartojnë dhe të nënshkruajnë një marrëveshje të veçantë për njohjen reciproke të dëftesave, diplomave, titujve dhe kualifikimeve profesionale, titujve akademikë, gradave (për Republikën e Shqipërisë), të lëshuara nga institucionet arsimore në vendet e tyre.

Neni 5

Palët Kontraktuese bien dakord që shkencëtarët, ekspertët, mësuesit akademikët, strukturat drejtuese, mund të ftohen të marrin pjesë në veprimtari që organizohen në kuadër të kësaj Marrëveshjeje. Shpenzimet e pjesëmarrjes në këto veprimtari mbulohen nga institucioni dërgues, përveç rasteve kur Palët kanë rënë dakord ndryshe.

Neni 6

Palët Kontraktuese do të përkrahin dhe nxisin pjesëmarrjen në programe dhe projekte të përbashkëta të Bashkimit Evropian, si “Erasmus+” dhe “Horizont 2020”, të Këshillit të Evropës, të UNESCO-s, dhe në nisma rajonale në fushën e arsimit dhe shkencës.

Neni 7

Palët Kontraktuese do të përkrahin dhe zgjerojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore në nivel rajonal dhe vendor, përfshirë këtu binjakëzimin e shkollave.

Neni 8

Me qëllim zbatimin sa më të suksesshëm të kësaj Marrëveshjeje dhe zgjidhjen e çështjeve të mundshme që mund të lindin gjatë zbatimit të saj, Palët Kontraktuese do të hartojnë programe bashkëpunimi zbatimi konkrete.

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të formojnë një këshill të përbashkët me numër të njëjtë përfaqësuesish nga secila Palë, i cili do të mbledhet me radhë në Shkup dhe në Tiranë, në datat e rëna dakord nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Këshilli i Përbashkët do të vlerësojë bashkëpunimin, do të japë sugjerime për përmirësimin e tij, do të japë zgjidhje për mosmarrëveshje të mundshme nëse shfaqen të tilla, mund të ftojë ekspertë të caktuar sipas fushave të veçanta të bashkëpunimit, etj.



Neni 9

Bashkëpunimi i caktuar në këtë Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me ligjet dhe dispozitat ligjore të secilit vend, si dhe në përputhje me konventat e organizatave ndërkombëtare, anëtare të së cilave janë Palët Kontraktuese. Palët Kontraktuese do të japin përkrahje të përgjithshme për realizimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale që lindin /rrjedhin nga veprimtaritë e bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje, rregullohet nga marrëveshjet konkrete ndërmjet institucioneve që gëzojnë këto të drejta, nga legjislacioni i brendshëm i secilës prej palëve në lidhje me këto të drejta, si dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare mbi të drejtat e pronësisë intelektuale, që janë të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Maqedonisë.

Neni 11

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do t'i zgjidhin nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Neni 12

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohen dhe plotësohen vetëm me miratim të ndërsjellë të Palëve Kontraktuese, të shprehur me shkrim.

Neni 13

Organet përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje janë: për Republikën e Shqipërisë – Ministria e Arsimit dhe Sportit, ndërsa për Republikën e Maqedonisë – Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 14

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit dërguar nëpërmjet rrugëve diplomatike, me anë të të cilit Pala tjetër informohet se janë plotësuar procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë pesëvjeçare. Pas përfundimit të kësaj periudhe, Marrëveshja rinovohet/përtërihet automatikisht çdo pesë vite, nëse asnjëra nga Palët nuk e informon Palën tjetër me shkrim për mosvazhdimin e Marrëveshjes, gjashtë muaj para skadimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Vlorë, më 2.7.2015 në dy ekzemplarë origjinalë, në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, ku të dy tekstet janë njësoj të vlefshme.

Në raste keqkuptimi lidhur me interpretimin e teksteve, do të vlejë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM

Nr. 782, datë 22.9.2015

**Për MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË SERBISË DHE ANËTARËVE TË
TJERË TË NISMËS PËR REFORMËN
ARSIMORE TË EVROPËS JUGLINDORE
(ERI SEE), PËR SELINË E
SEKRETARIATIT TË ERI SEE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Serbisë dhe anëtarëve të tjerë të Nismës për Reformën Arsimore të Evropës Juglindore (ERI SEE), për selinë e sekretariatit të ERI SEE, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË DHE ANËTARËVE TË TJERË TË NISMËS PËR REFORMËN ARSIMORE TË EVROPËS JUGLINDORE (ERI SEE) PËR SELINË E SEKRETARIATIT TË ERI SEE

Anëtarët e Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore (më poshtë e quajtur ERI SEE) si Palë në këtë Marrëveshje (më poshtë të quajtura “Palët”);

bazuar në angazhimet e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Rolin dhe Organizimin e Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore (ERI SEE), të nënshkruar në Brdo, Slloveni më 5 qershor 2010 nga ministrat përgjegjës për arsimin dhe arsimin e lartë të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë, me pjesëmarrjen e të ftuarve të veçantë: një përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR-RCC) dhe Kryetari i KBR, Task Force për Edukimin e dhe Krijimin e Kapitalit Njerëzor (TKEKKN), Republika e Moldavisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, që aderuan në Memorandumin e Mirëkuptimit nëpërmjet protokolleve të nënshkruara përkatësisht nga ministrat përkatës të arsimit dhe kryetari i ERI SEE, më 27 dhjetor 2010 dhe 11 mars 2011 (më poshtë i quajtur “Memorandumi i Mirëkuptimit MM”);

duke marrë në konsideratë se Memorandumi i Mirëkuptimit parashikon krijimin e Sekretariatit të ERI SEE me seli në një nga Vendet Anëtare të ERI SEE;

duke rikujtuar vendimin unanim të Bordit Drejtues për të pranuar propozimin e Republikës së Serbisë për të caktuar Beogradin si selinë e re të Sekretariatit të ERI SEE-së;

me dëshirën për të rregulluar privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për mbarëvajtjen dhe realizimin me sukses të misionit të Sekretariatit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Vendi pritës” do të quhet Republika e Serbisë;

b) “Qeveria e vendit pritës” do të quhet Qeveria e Republikës së Serbisë;

c) “Sekretariat” do të quhet Sekretariati i Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore;

d) “Drejtori i Sekretariatit” do të quhet një person i caktuar si drejtor i Sekretariatit të Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore;

e) “Anëtar stafi” do të quhet një anëtar i stafit të Sekretariatit që kryen detyra me kohë të plotë në Sekretariat, duke përfshirë ato të përcaktuara në nënparagrafin “j” dhe “k” të këtij neni;

f) “Staf ndërkombëtar” do të quhet një anëtar stafi, i cili nuk është as shtetas i Republikës së Serbisë, as shtetas i huaj me banim të përhershëm në Republikën e Serbisë;

g) “Stafi (i rekrutuar) vendas” do të quhet një anëtar stafi, shtetas i Republikës së Serbisë, ose një shtetas i huaj me banim të përhershëm në Republikën e Serbisë;

h) “Anëtar familjeje” do të quhen një bashkëshort/e dhe fëmijët në varësi deri në moshën 26 vjeç, me kusht që ata të jetojnë në Republikën e Serbisë në të njëjtën shtëpi me anëtarët e stafit të Sekretariatit, dhe të mos jenë as shtetas të Republikës së Serbisë, as shtetas të huaj me banim të përhershëm në Republikën e Serbisë;

i) “Godina e Sekretariatit” do të quhen godina, duke përfshirë tokën mbi të cilën ndodhet ndërtesa e zënë nga Sekretariati dhe që përdoret vetëm për qëllimet e Sekretariatit, pavarësisht pronësisë së përcaktuar në shtojcën 1;

j) “Ekspert” do të quhet një person që kryen një detyrë të përkohshme për Sekretariatit, përveç veprimtarive të përcaktuara në nënparagrafët “e” dhe “k” të këtij neni;

k) “Përfaqësues” do të quhet një përfaqësues i autorizuar i një anëtari të Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore;

l) “Statut” do të thotë Statuti i Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore;

m) “Bordi Drejtues” do të quhet Bordi Drejtues i Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore.

Neni 2

Selia

1. Sekretariati themelohet nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje. Selia e Sekretariatit do të jetë në Beograd, Republikën e Serbisë.



2. Qeveria e vendit pritës do t'i ofrojë falas Sekretariatit godinën, ndihmë komunikimi dhe logjistike, siç është përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje, të nevojshme për përmbushjen efektive të funksioneve të saj në përputhje me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3 Statusi ligjor

1. Sekretariati do të ketë personalitetin ligjor dhe cilësinë juridike të nevojshme për të kryer funksionet e tij në mënyrë që të lidhë kontrata, të blejë dhe të shesë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të kryejë procedime ligjore në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

2. Vendi pritës do të lehtësojë procedurat e marrjes së dokumenteve të përshtatshme me qëllim rregullimin e statusit ligjor të Sekretariatit.

Neni 4 Kontributi financiar

1. Palët marrin përsipër të ofrojnë kontributet e tyre financiare vjetore për buxhetin vjetor të Sekretariatit në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, në veçanti shtojcën 3 të Memorandumit, bashkëlidhur si shtojca 2 për lehtësi referimi.

2. Pas përfundimit të periudhës së parashikuar në shtojcën 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit, ose në rast aderimesh të reja, Palët do të sigurojnë kontributet e tyre financiare në përputhje me vendimet e Bordit Drejtues, ashtu siç parashikohet në Statut.

3. Përveç kontributit financiar vjetor, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, shtojca 3, vendi pritës do të sigurojë një kontribut financiar shtesë mbi një bazë vjetore për shpenzimet operative të Sekretariatit të përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5 Rregullat ndërkombëtare

1. Sekretariati mund të miratojë rregulla të brendshme të nevojshme për zbatimin dhe organizimin e funksioneve të tij, në përputhje me Statutin.

2. Sekretariati do të informojë autoritetet kompetente të vendit pritës mbi rregullat e brendshme përkatëse.

Neni 6

Logoja dhe emërtimet

1. Sekretariati mund të ekspozojë flamurin, logon dhe simbole të tjera në godinën e tij dhe mbi mjetet motorike të Sekretariatit.

2. Mjetet motorike të Sekretariatit do të kenë të drejtën e regjistrimit diplomatik dhe statusit përkatës.

Neni 7

Imuniteti nga procesi gjyqësor dhe detyrimi

1. Sekretariati do të gëzojë imunitet nga procesi gjyqësor, gjyqësori dhe nga ndonjë detyrim tjetër që zbatohet në vendin pritës, përveçse në rast se paraqitet një kundërpretendim i lidhur drejtpërsëdrejti me pretendimin e ngritur nga Sekretariati ose në rastin kur Bordi Drejtues ka hequr dorë qartë nga ky imunitet. Megjithatë, vetëkuptohet që një heqje e tillë e imunitetit nuk do të zbatohet për çdo masë detyruese. Heqja e imunitetit si masë detyruese duhet të jepet në mënyrë të qartë.

2. Pa cenuar paragrafin 1 të këtij neni, Sekretariati do të përpiqet të zgjidhë nëpërmjet negociatave, ose nëse negociatat dështojnë, atëherë nëpërmjet zgjidhjeve alternative të konflikteve, të gjitha kontradiktat që lindin nga:

a) ndonjë kontratë për blerje mallrash dhe shërbimesh, ndonjë hua apo transaksione bankare që synojnë financim, si dhe ndonjë marrëdhënie garancie apo dëmshpërblimi në lidhje me ndonjë transaksion apo ndonjë detyrim tjetër financiar;

b) Mosmarrëveshjet në punë.

Në rast se mosmarrëveshjet lidhur me çështjet e trajtuara në paragrafin 2, nënparagrafët "a" dhe "b", nuk mund të zgjidhen përmes negociatave, gjykata përkatëse e vendit pritës do të jetë përgjegjëse për zgjidhjen e tyre. Mosmarrëveshjet do të zgjidhen në përputhje me ligjet e vendit pritës.

3. Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Sekretariatit, të kudondodhura dhe të poseduara nga kushdo në vendin pritës, do të gëzojnë imunitet nga ndonjë masë detyruese, përfshirë konfiskimin, marrje me forcë, ngrirje ose çdo formë tjetër detyrimi, konfiskimi apo shpronësimi, të parashikuara nga ligjet e vendit pritës.



Neni 8

Paprekshmëria e sekretariatit

1. Godina dhe prona e Sekretariatit janë të paprekshme.

2. Vendi pritës duhet të garantojë që selia e Sekretariatit të jetë e pacenueshme. Autoritetet kompetente të vendit pritës do të kenë të drejtë të hyjnë në ambientet e Sekretariatit për kryerjen e detyrave të tyre, vetëm me pëlqim të drejtorit të Sekretariatit ose të një zyrtari të autorizuar të Sekretariatit, sipas kushteve të rëna dakord mes tyre. Megjithatë, në rast zjarri ose emergjencash të ngjashme, një pëlqim i tillë do të konsiderohet i dhënë nëse kërkohen masa mbrojtje jetë menjëhershme.

3. Dokumentet dhe materialet arkivore të Sekretariatit, duke përfshirë gjithë aplikimet kompjuterike dhe fotografitë që i përkasin atij ose janë pronë e tij, janë të paprekshme.

4. Qeveria e vendit pritës do të ndërmarrë të gjitha masat për të ruajtur godinën e Sekretariatit kundër çdo ndërhyrje apo dëmtim, shqetësim apo shkelje të dinjitetit të Sekretariatit.

Neni 9

Publikimet

Importi dhe eksporti i publikimeve, si dhe i çdo materiali tjetër informues i importuar apo eksportuar nga Sekretariati për përdorimin e tij zyrtar, nuk do të t'i nënshtrohet asnjë lloj kufizimi.

Neni 10

Përdorimi i fondeve

Sekretariati, me qëllim kryerjen e funksioneve të tij, do të ketë të drejtë të marrë, të mbajë, të shkëmbejë, të transferojë të gjitha fondet, monedhat, para në dorë (kesh) dhe të heqë ato lirisht, në përputhje me rregullat e vendit pritës. Kjo e drejtë do të përfshijë, por nuk do të kufizojë, të drejtën për të mbajtur një llogari jorezidenciale në një bankë biznesi në vendin pritës.

Neni 11

Shërbimet e nevojshme

1. Autoritetet kompetente të vendit pritës, me kërkesë të Sekretariatit, do t'i sigurojnë atij shërbimet e nevojshme me qëllim kryerjen e funksioneve të tij.

2. Çmimet për shërbimet e nevojshme të përmendura më sipër, që nuk janë objekt i shtojcës 1, nuk do t'i tejkalojnë çmimet më të ulëta të krahasueshme me ato të miratuara për misionet diplomatike.

3. Me kërkesë të autoriteteve kompetente të vendit pritës, drejtori i Sekretariatit duhet t'u kërkojë qasje përfaqësuesve të autorizuar prej kompanive të shërbimit, për të kontrolluar, riparuar, mbajtur ose për të zhvendosur instalimet në godinën e Sekretariatit sipas nevojës, me kusht që kjo të mos cenojë funksionimin e Sekretariatit.

Neni 12

Përrjashtimet nga detyrimet dhe taksat

1. Sekretariati, pasuritë e tij, të ardhurat dhe pronat e tjera do të përjashtohen nga taksat kombëtare dhe vendore. Ky përjashtim nuk do të zbatohet për taksat dhe përvetësimet të cilat konsiderohen si pagesa për shërbimet të nevojshme, të ofruara sipas normave të vendosura, sipas sasisë së shërbimeve të kryera, të cilat mund të identifikohen, përshkruhen dhe ndahen.

2. Në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar e përfshirë në çmime apo për t'u paguar veçmas, përjashtime do të bëhen vetëm për sasi të arsyeshme të artikujve të blerë dhe shërbimeve të kryera për përdorim zyrtar nga Sekretariati, në këtë rast mallrat e blera për përdorimin e tij, për të cilat zbatohen përjashtime nga taksat në përputhje me këtë masë, nuk mund të shiten, të falen ose të përdoren në ndonjë mënyrë tjetër, përveç se sipas kushteve për të cilat është rënë dakord me qeverinë e vendit pritës.

Neni 13

Përrjashtimi nga detyrimet e importit

1. Sekretariati do të ketë të drejtën të importojë pa paguar taksa doganore sasi të arsyeshme mallrash për përdorimin e tij zyrtar, duke përfshirë mjetet motorike.

Neni 14

Sigurime shoqërore

1. Drejtori dhe anëtarët e stafit të Sekretariatit, me kusht që ata të jenë staf ndërkombëtar, do të përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme për çdo lloj sigurimi shoqëror në vendin pritës.



2. Drejtori dhe anëtarët e stafit të Sekretariatit, me kusht që ata të jenë staf vendas, do të jetë subjekt i kontributeve të detyrueshme në përputhje me legjislacionin e Republikës së Serbisë.

Neni 15

Drejtori i Sekretariatit

1. Gjatë tërë mandatit të tij në vendin pritës, drejtorit të Sekretariatit do t'i ofrohen të njëjtat privilegje si për shefat e zyrove të ngjashme të organizatave ndërkombëtare në vendin pritës.

2. Drejtori, i cili është anëtar i stafit ndërkombëtar, gëzon imunitetet dhe privilegjet e parashikuara në nenin 16 më poshtë.

3. Pa cenuar paragrafin 1 të këtij neni, drejtori, një punonjës vendas nuk do të gëzojnë asnjë imunitet apo privilegj mbështetur në këtë marrëveshje, duke përfshirë imunitet nga procedimi gjyqësor për veprime të kryera gjatë zbatimit të detyrave të tyre, përfshirë fjalë të thëna apo të shkruara.

Neni 16

Privilegjet dhe imunitetet e stafit ndërkombëtar

1. I gjithë stafi ndërkombëtar do të gëzojë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme në vendin pritës:

a) Imunitet juridik për veprime të kryera gjatë zbatimit të funksioneve të tyre, përfshirë fjalët e thëna apo shkruar prej tyre edhe kur ata nuk punojnë më për Sekretariatit;

b) Imunitet nga kërkimi dhe konfiskimi i bagazhit të tyre personal;

c) Përfshirë nga taksat dhe kontributet mbi pagat, shpërblimet dhe kompensimet, që Sekretariatit u ka paguar atyre për shërbimet e kryera;

d) Përfshirë nga TVSH-ja për sasi të arsyeshme mallrash dhe shërbimesh për përdorim personal të anëtarëve të stafit në përputhje me legjislacionin e vendit pritës;

e) Përfshirë nga kufizimet e emigracionit dhe detyrimit për të regjistruar veten dhe anëtarët e tyre të familjes që janë pjesë e familjeve të tyre në përputhje me regjimin e vizave të vendit pritës;

f) E njëjta mbrojtje dhe lehtësi riatdhesimi për veten dhe anëtarët e familjeve të tyre, siç u është dhënë zyrtarëve në nivel të krahasueshëm në misionet diplomatike;

g) E drejta për të importuar për përdorim personal, pa paguar detyrime importi apo taksa të tjera, me kusht që këto të mos jenë taksa për kryerjen e shërbimeve të nevojshme, si dhe përjashtim nga pengesat e importit dhe kufizimet e import-eksportit:

i) mobiliet dhe sendet personale që në momentin marrjes së detyrës, në një apo më shumë ngarkesa,

ii) një mjet motorik.

Neni 17

Stafi i punësuar në vend

1. Stafi i rekrutuar në vend do të punësohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të vendit pritës.

2. Stafi i rekrutuar në vend, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të gëzojë imunitet apo privilegj, përfshirë imunitet nga procedimi gjyqësor për veprime të kryera gjatë zbatimit të detyrave të tyre, duke përfshirë fjalë të thëna apo të shkruara.

Neni 18

Ekspertët

Ekspertët, nëse nuk janë shtetas të vendit pritës ose shtetas të huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) Imunitet nga juridiksioni gjyqësor për veprimet e kryera gjatë zbatimit të detyrave të tyre, duke përfshirë fjalë të thëna apo shkruara në funksionin e tyre zyrtar;

b) Paprekshmëria e gjithë letrave zyrtare, të dhëna mediatike dhe dokumenteve në përputhje me procedurat në fuqi;

c) Përfshirë nga kufizimet e emigracionit në përputhje me rregullat e vendit pritës.

Neni 19

Përfaqësuesit

Përfaqësuesit, nëse nuk janë shtetas të vendit pritës apo shtetas të huaj me banim të përhershëm në vendin pritës, gjatë periudhës së kryerjes së detyrave të tyre në vendin pritës, si dhe gjatë udhëtimeve të tyre në këtë territor, do të gëzojnë privilegjet e mëposhtme:

a) Imunitet nga juridiksioni për veprimet e kryera gjatë zbatimit të detyrave të tyre, duke përfshirë fjalë të thëna apo shkruara në funksionin e tyre zyrtar;



b) Përrjashtime nga kontrolli dhe sekuestrimi i bagazheve personale;

c) Paprekshmëria e dokumenteve zyrtare, të dhënave dhe materialeve të tjera;

d) Përrjashtime nga kufizimet e emigracionit në përputhje me rregullat e vendit pritës.

Neni 20

Përrjashtime nga imuniteti

Anëtarët e stafit, ekspertët dhe përfaqësuesit nuk do të gëzojnë imunitet në lidhje me çdo veprim që lidhet me shkeljen e rregullave të qarkullimit.

Neni 21

Heqja dorë nga imuniteti

1. Privilegjet dhe imunitetet nuk do t'i jepen për përfitim personal individëve, por për të siguruar funksionimin efikas të Sekretariatit, në përputhje me qëllimet e tij.

2. Bordi Drejtues do të ketë të drejtë dhe detyrim të heqë imunitetin për çdo anëtar të stafit të Sekretariatit në çdo rast ku, sipas mendimit të tij imuniteti do të pengojë zbatimin e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesin e nismës ERI SEE ose të Sekretariatit. Heqja e imunitetit nga juridiksioni gjyqësor duhet të jepet gjithmonë me shkrim.

3. Heqja e imunitetit nga juridiksioni gjyqësor në përputhje me procedurat administrative nuk do të bëhet për të hequr imunitetin, me qëllim zbatimin e vendimit gjyqësor për të cilin do të jetë i nevojshëm një dokument i veçantë heqje imuniteti.

Neni 22

Njoftimi

1. Sekretariati do t'i ofrojë Protokollit Diplomatik të Ministrisë të Punëve të Jashtme të vendit pritës:

a) Listën e stafit ndërkombëtar dhe të anëtarëve të tyre të familjes që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, menjëherë ose të paktën brenda tre ditësh nga data e mbërritjes së tyre;

b) Sekretariati gjithashtu duhet të njoftojë mbi përfundimin e detyrës të çdo stafi ndërkombëtar sipas pikës "a", dhe sipas nevojës, nëse një person pushon së qeni anëtar i një familjeje përkatëse.

2. Stafi ndërkombëtar që është paraqitur në përputhje me paragrafin e mëparshëm, pajiset me

dokumentacionin e duhur të identifikimit nga Protokollit Diplomatik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Serbe.

Neni 23

Përgjegjësia e vendit pritës

Vendi pritës nuk do të jetë përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e kryera nga Sekretariati dhe stafi i tij brenda territorit të tij.

Neni 24

Çështjet e sigurisë

1. Në këtë Marrëveshje asgjë nuk do të përjashtojë të drejtën e qeverisë së vendit pritës të marrë masat e duhura mbrojtëse në interes të sigurisë publike apo të ndalojë zbatimin e ligjeve të saj, të cilat janë të nevojshme për ruajtjen e rendit dhe shëndetit publik.

2. Nëse qeveria e vendit pritës e çmon të nevojshme zbatimin e masave të parashikuara në paragrafin 1 më lart, kur rrethanat e lejojnë, ajo do të kontaktojë Sekretariatit në mënyrë që të marrin një vendim të përbashkët mbi masat që mund të jenë të nevojshme për të mbrojtur interesat e Sekretariatit.

3. Sekretariati do të jetë i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet e vendit pritës për të shmangur çdo dëmtim të sigurisë publike që shkaktohet si rezultat i aktivitetit të Sekretariatit.

Neni 25

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet, për sa i përket zbatimit dhe interpretimit të kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen përmes negociatave ndërmjet Palëve.

Neni 26

Amendamentet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqim të ndërsjellë të Palëve. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 27 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 27

Hyrja në fuqi, kopjet origjinale dhe depozitari

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Ministria e Punëve të Jashtme e vendit pritës merr njoftimin e katërt nga Palët, duke përfshirë



edhe vendin pritës, pasi të jenë përfunduar procedurat e brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi.

2. Për secilën Palë, e cila, pas depozitimit të njoftimit të katërt në përputhje me nenin 1, njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të vendit pritës për plotësimin e procedurave të saj të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, ajo do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit bërë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

3. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes, origjinali do të depozitohet pranë qeverisë së vendit pritës, e cila do të shërbejë si depozitari. Depozitari do t'u ofrojë Palëve të Marrëveshjes dhe Sekretariatit kopje të noterizuara të saj.

4. Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht që nga data e nënshkrimit të saj. Secila Palë mund të deklarojë në momentin e nënshkrimit se Marrëveshja do të zbatohet që nga data e përfundimit të procedurave përkatëse të brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

Neni 28

Vlefshmëria, pezullimi, aderimi, anulimi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe.

2. Një Palë tjetër aderuese në Memorandumin e Mirëkuptimit gjithashtu do të aderojë në këtë Marrëveshje, në përputhje me dispozitat e nenit 27 të kësaj Marrëveshjeje.

Qeveria e vendit pritës do të ketë të drejtë ta anulojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar Palët me shkrim për këtë qëllim. Në atë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë gjashtë (6) muaj pas marrjes së këtij njoftimi.

3. Secila Palë mund të anulojë këtë Marrëveshje duke njoftuar me shkrim depozitarin dhe palët e tjera. Në atë rast, Marrëveshja do të shfuqizohet për palën kërkuese gjashtë (6) muaj pas marrjes së njoftimit nga depozitari.

“Në dëshmi sa më sipër, nënshkruesit e autorizuar rregullisht nga qeveritë përkatëse kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.”

Bërë në _____, sot më _____ 2012, në një origjinal në gjuhën angleze.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Serbisë

Ministri i Arsimit dhe i Shkencës

Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

Në emër të Qeverisë së Republikës së Bosnjë-Hercegovinës

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kroacisë

Në emër të Qeverisë së Malit të Zi

Në emër të Qeverisë së Republikës së Moldavisë

Në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

SHTOJCA I GODINA, PAJISJET, SHËRBIMET FINANCIARE DHE KONTRIBUTE TË TJERA ZYRE OFRUAR NGA VENDI PRITËS

Neni 1

Godina dhe pajisjet

Vendi pritës duhet t'i vendosë në dispozicion Sekretariatit në përputhje me këtë Marrëveshje:

a) Godinën e Selisë së Sekretariatit, pronë e Republikës së Serbisë, me sipërfaqe totale prej 40 m², e vendosur në Beograd. Godina përfshin dy zyra dhe një sallë konferencash.

b) Qeveria e vendit pritës do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përshtatjen dhe rinovimin në përputhje me nevojat e Sekretariatit.

c) Pajisjet në zyrë do të përfshijnë:

- 3 tavolina zyre;

- 3 karrige zyre;

- 1 tavolinë konferencash me 20 karrige;

- 3 kompjuterë (me monitorë, tastiera dhe mause);

- 3 printera lazer;

- 2 laptopa;

- 1 projektor;

- 1 fotokopje;



- 3 telefona me central;
- 1 faks;
- 3 kondicionerë;
- 3 bufe;
- 3 rafte me sirtarë;
- 1 tavolinë kafeje me 4 karrige;
- 3 tapete;
- 1 frigorifer;
- 1 aparat kafeje.

d) Vendi pritës do të sigurojë gjithë shërbimet e nevojshme për funksionimin e Sekretariatit duke

përfshirë, por pa u kufizuar te linjat telefonike dhe përdorimi i internetit.

Neni 2

Mbështetja financiare

Vendi pritës, përveç kontributit të tij vjetor, duhet të ofrojë një sasi prej 20,000 euro mbi bazë vjetore për shpenzime operative të Sekretariatit.

SHTOJCA 2

Neni 1

SHTOJCA 3

BUXHETI VJETOR PËR PERIU DHËN 2011-2013

Llogaritja e kontributit vjetor të anëtarëve të ERI SEE në favor të ERI SEE (kostot totale dhe operative) është kryer në përputhje me metodologjinë e zhvilluar për kontributin në RCC¹. Anëtarët e ERI SEE kategorizohen në katër grupe sipas niveleve të tyre të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) në bazë të fuqisë blerëse (BFB), si më poshtë:

Grupi	PBB në BFB, miliardë \$ ²	Kontributi vjetor në € për Anëtarët
I	<10.0	€ 5.400
II	<50.0	€ 7.200
III	>50.0	€ 9.000
IV	>70.0	€ 14.400

- Për nënshkruesit e pranishëm, kontributi vjetor për periudhën 2011-2013 është: për Shqipërinë (Grupi II): 7.200 €; për Kroacinë (grupi IV): 14.400€; për Maqedoninë (grupi II): 7.200€; për Malin e Zi (grupi I): 5.400€; dhe për Serbinë (grupi III): 9.000€. Bordi Drejtues i ERI SEE në këshillim me ministrat e arsimit të anëtarëve të ERI SEE mund të përcaktojë një nivel tjetër kontributi pas periudhës fillestare prej tre vitesh.

- Vendi i ardhshëm pritës do të flokojë afërsisht 20.000€ për shpenzime operative të specifikuar në shtojcën 2, përveç kontributit të tij vjetor.

- Financime të tjera vjetore nga burime të tjera; 110.000€, nga të cilat 15.000€ janë për shpenzime operative, janë kontribute të pritshme për vitin 2011 nga Austria, Holanda dhe Zvicra.

- Shuma e kontributit vjetor e ndonjë pale tjetër të mundshme në të ardhmen, që i bashkohet këtij Memorandumi, përllogaritet në përputhje me metodologjinë e përmendur më lart dhe informacionin e kontributit të pritshëm, i cili formalisht u komunikohet ministrive kompetente të rajonit të ERI SEE.

- Duke supozuar dhjetë anëtarë, projektbuxheti vjetor i ERI SEE është 220.000€, nga të cilat rreth 75.000€ ndahen për kostot operative (Sekretariati i ERI SEE).

1 Metodologjia përfshin llogaritje të kontributit për një periudhë trevjeçare.

2 Prodhimi i brendshëm bruto në paritet/barazi të fuqisë blerëse. Burimi: FMN, tetor 2009



MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

mbi rolin dhe organizimin e Nismës së Reformës në Arsim të Evropës Juglindore (ERI SEE)

Neni 2

Për Republikën e Moldavisë dhe Bosnjë-Hercegovinës që aderuan në Memorandumin e Mirëkuptimit nëpërmjet protokollove të nënshkuara nga ministrat përgjegjës të arsimit dhe kryetari i ERI SEE, përkatësisht më 27 dhjetor 2010 dhe 11 mars 2011, në përputhje me shtojcën 3 të Memorandunit të Mirëkuptimit, kontributi vjetor për periudhën 2011-2013 është:

- Moldavia 5,400.00 euro dhe
- Bosnjë-Hercegovina 7,200.00 euro

VENDIM

Nr. 786, datë 22.9.2015

**PËR SHPALLJEN E ZONAVE
ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË
VENDBANIMIT TË KOMANIT
(DALMACJA E VJETËR) DHE
MIRATIMIN E RREGULLORES SË
ADMINISTRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 30, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të Vendbanimit të Komanit (Dalmacia e Vjetër),


sipas hartës dhe koordinatave gjeografike bashkë-lidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullore “Për administrimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të Vendbanimit të Komanit (Dalmacia e Vjetër)”, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Bashkia e Vaut të Dejes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





RREGULLORE

PËR ADMINISTRIMIN E ZONAVE ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B”, TË VENDBANIMIT TË KOMANIT (DALMACJA E VJETËR)

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B”, të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër), mbështetur në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.

Neni 2

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A”, të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër)

Në zonën arkeologjike “A”, të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër), lejohet:

1. rikonstruksioni i rrugëve dhe punimet për rrjetet e infrastrukturës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, në vazhdim “KKA”, dhe nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në vazhdim “KKR”;

2. restaurimi e konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e formave të testimit, të përcaktuara me vendim të KKA-së, projektet kërkimore shkencore, të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKA-ja dhe KKR-ja;

3. vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal), me lartësi maksimale 3m, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara.

Konstruksionet, të cilat vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe, në asnjë rast, nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peisazhin, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik dhe nevojave të tjera që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, në veçanti, dhe trashëgiminë kulturore, në përgjithësi.

Projekti për këto ndërhyrje miratohet nga KKA-ja dhe KKR-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Neni 3

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “B”, të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër)

Në zonën arkeologjike “B”, të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër), përveç ndërhyrjeve të parashikuara në zonën arkeologjike “A”, lejohen edhe:

1. zhvillimet ndërtimore, pas miratimit me shkrim nga KKA-ja dhe KKR-ja të kërkesave të subjekteve të interesuara;

2. punime zhvillimore, vetëm pas kryerjes së formave të testimit, në varësi të potencialit që përfaqëson zona, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë. Format e testimit përcaktohen nga KKA-ja.

3. Në rastet kur gjatë zbatimit të projektit zhvillimor zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë, projekti duhet të rishikohet dhe shqyrtohet në KKA. KKA-ja miraton ndryshimet në projekt, duke marrë në konsideratë konservimin dhe bërjen e tyre të vizitueshme. Vetëm pas miratimit të ndryshimeve lejohet vazhdimi i punimeve.

4. Ndërtimet e reja nuk duhet të kalojnë lartësinë e përcaktuar nga PPV-ja (Plani i Përgjithshëm Vendor) dhe PDV (Plani i Detajuar Vendor).

Neni 4

Procedurat për ndërhyrjet zhvillimore në zonën arkeologjike “B”

1. Për çdo ndërhyrje në zonën arkeologjike “B” subjekti ndërtues i interesuar duhet të marrë konfirmimin nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, në vazhdim “DRKK”, përgjegjëse për Vendbanimin e Komanit, dhe duhet të paraqesë pranë sekretarisë teknike të KKA-së dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kërkesë për kryerje punimesh, të firmosur nga investitori ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose me prokurë. Nëse kërkesa është firmosur nga përfaqësues me prokurë, kjo e fundit duhet të jetë hartuar para noterit dhe të depozitohet në formën e kërkuar nga ligji (originale ose e noteruar);

b) Mendimi i DRKK-së përkatëse për kërkesën e subjektit, për zonën ku do të ndërhyhet;

c) Fotokopje e planit të detajuar vendor/plani i përgjithshëm vendor, të konfirmuar nga institucioni përkatës;

ç) Ekstraktin e Regjistrit Tregtar për të Dhënat



e Subjektit, Ekstraktin mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të investitorit, në formën e kërkuar nga ligji (origjinale ose e notuar).

d) Projektin teknik të strukturës (edhe në CD), të firmosur nga projektuesi i licencuar, i cili duhet të përmbajë:

i) genplanin, me koordinatat sipas Sistemit Koordinativ Shqiptar, të konfirmuar nga një inxhinier topograf, ku të jetë evidentuar zona ku do të ndërhyhet. Sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për shpalljet e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qyteteve përkatëse, të hidhet në këtë genplan edhe kufiri i këtyre zonave.

ii) prerjet gjeologjike të terrenit, sipas studimit gjeologjik të kryer;

iii) planvendosjen e objektit, planet e kateve nëntokë dhe mbi tokë;

iv) prerjen e strukturës dhe detaje që tregojnë thellësinë e themeleve;

v) pamje teknike dhe tredimensionale të strukturës;

vi) fletët e prerjeve, ku duhet të jepen kuotat përfundimtare të themeleve, që do të përcaktojnë, kështu, dhe kuotën maksimale të gërmimit;

dh) Relacionin teknik të projektit, të firmosur nga një projektues i licencuar;

e) Licencën e notuar të projektuesit, brenda afatit të vlefshmërisë dhe sipas kategorisë, për ndërtimin e objektit që kërkohet të zhvillohet.

2. Materiale që duhen për paraqitjen në KKA:

I. materialin në *PowerPoint* të projektit të strukturës(CD) dhe përmbledhje të relacionit;

II. harta në format A3 e zonës, ku të evidentohet sipërfaqja ku do të kryhen punime, rrugët ekzistuese dhe të reja që të çojnë te ajo dhe të evidentohen ato që do të kenë nevojë për kryerje punimesh, si dhe konturi i zonave arkeologjike “A” dhe “B” .

3. Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës së subjektit nga KKA-ja, nënshkruhet kontrata disipalëshe, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Ndërhyrjet pa leje në zonat arkeologjike “A” dhe “B”

1. Për ndërhyrjet pa leje brenda zonave arkeologjike “A” dhe “B”, DRKK-ja përgjegjëse për Vendbanimin e Komanit pezullon menjëherë veprimtarinë e subjektit dhe njofton Inspektoratin

Ndërtimor Urbanistik Vendor dhe Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për pezullimin e ndërtimit deri në prishjen e tij.

2. Për të gjitha veprimet e ndërmarra dhe procesverbalet e mbajtura në terren, DRKK-ja vë në dijeni Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.

Neni 6

Penalitetet në zonat arkeologjike “A” dhe “B”

Në rast të shkeljeve të procedurave nga subjektet ndërtues, KKA-ja nuk merr në shqyrtim, për një periudhë 3-vjeçare, asnjë kërkesë të subjektit, si dhe të drejtuesit teknik përkatës, për punime që lejohen në zonat arkeologjike “A” dhe “B”, në të gjithë territorin e vendit apo në zona të tjera ku, sipas ligjit, kërkohet miratimi i KKA-së dhe KKR-së.

Neni 7

Gjetjet arkeologjike në zonën “B”

1. Në rast gjetjesh të rëndësishme arkeologjike, punimet e nisura pezullohen menjëherë nga institucionet e specializuara (DRKK dhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në vazhdim ASHA). Brenda një afatit 10-ditor, nga dita e ndërprerjes së punimeve, KKA-ja vendos për veprimet e mëtejshme. Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara ndërpriten përfundimisht. Vendimi, në këtë rast, merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve, KKA-ja.

2. Sekretaria teknike, në mbështetje të vendimit të KKA-së, përgatit vendimin përkatës në tri kopje, njëra prej të cilave, pas nënshkrimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, protokollimit e vulosjes, ia dorëzon subjektit të interesuar, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së vendimit.

3. Shpenzimet për kryerjen e hulumtimeve të nevojshme, përgatitjen e dokumentacionit si dhe për ndryshimet e mundshme të projektit, kur vendoset që gjetjet të mbrohen në vend (*in situ*), si dhe shpenzimet për kërkimet shkencore, veprimtaritë e nevojshme restauruese ose konservuese, mbulohen 100% nga investitori.

4. Në rast të gjetjeve arkeologjike të rëndësishme, kur KKA-ja vendos ndërprerjen përfundimtare të punimeve, investitori shpronësohet, në bazë të kuadrit ligjor në fuqi.



Neni 8

Gërmimet e shpëtimit

1. Në rast gjetjesh arkeologjike të rëndësishme, KKA-ja vendos kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit. KKA-ja përcakton subjektet që do të kryejnë, përkatësisht, gërmimin arkeologjik të shpëtimit dhe mbikëqyrjen e tij.

2. Gjatë kryerjes së gërmimit të shpëtimit mund të kërkohet asistencë shkencore dhe teknike, në terren, nga institucionet e specializuara shtetërore /përfaqësuesit e projektit kërkimor-shkencor, të cilët do të përcaktohen, rast pas rasti, nga KKA-ja.

3. Nëse pas kryerjes së gërmimit të shpëtimit zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë (strukturore etj.), institucionet e specializuara (DRKK, ASHA) pezullojnë gërmimin dhe propozojnë në KKA ndryshimet në projekt, me synim mbrojtjen dhe bërjen të vizitueshme të këtyre vlerave.

4. Vazhdimi i punimeve zhvillimore përcaktohet me vendim të KKA-së.

5. Në përfundim të çdo gërmimi shpëtimit përgatitet një relacion i plotë, i cili i paraqitet KKA-së për miratim brenda 30 ditëve. Pas shqyrtimit dhe miratimit, një kopje e relacionit të plotë depozitohet edhe pranë Institutit të Arkeologjisë.

6. Kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga ASHA-ja, raporti firmoset nga drejtuesi i grupit dhe nga anëtarët e tij dhe konfirmohet nga përgjegjësi /përgjegjësit e sektorëve përkatës.

7. Kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga një subjekt privat, raporti firmoset/konfirmohet nga drejtuesi i projektit të subjektit dhe minimumi 2 arkeologë të këtij subjekti. Raporti i gërmimit të shpëtimit, shoqëruar nga dokumentacioni, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzohet pranë ASHA-së dhe, më tej, miratohet në KKA.

Neni 9

Procedurat teknike

1. Të gjitha format e testimit kryhen nga subjektet, sipas vendimit të KKA-së.

2. Kur subjekti privat, i licencuar në arkeologji, kryen shkelje, duke mos respektuar legjislacionin në fuqi, institucionet e specializuara (DRKK, ASHA) pezullojnë gërmimin arkeologjik të shpëtimit dhe informojnë menjëherë KKA-në, duke propozuar edhe masat përkatëse.

3. KKA-ja, pasi shqyrton rastin, vendos lënie në fuqi të pezullimit të gërmimit arkeologjik të

shpëtimit nga subjekti privat i licencuar dhe ia delegon vazhdimin e tij ASHA-së.

4. Vendimi i KKA-së është i formës së prerë.

Neni 10

Zhvillimi i aktiviteteve kulturore

1. Për çdo veprimtari me karakter kulturor në zonat arkeologjike “A” dhe “B” të Vendbanimit të Komanit, vendosja e tabelave dhe e materialeve publicitare lejohet në raste të veçanta festivo-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm. Vendosja e tyre ekzekutohet vetëm në zbatim të urdhrat të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe nën mbikëqyrjen e DRKK-së përgjegjëse për Vendbanimin e Komanit.

2. Është e ndaluar vendosja e posterave publicitare jokulturorë dhe politikë si dhe dëmtimet e tjera të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme).

Neni 11

Harta e zonifikimit arkeologjik të Vendbanimit të Komanit

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet periodikisht, bazuar në të dhënat e reja arkeologjike dhe në nevojën për mbrojtjen e monumenteve të kulturës.

Neni 12

Zhvillimi i territorit

Në hartimin e instrumenteve të planifikimit të territorit (PPV/PDV), për zonën në të cilën gjendet Vendbanimi i Komanit, duhet të merret parasysh zonifikimi arkeologjik i këtij vendbanimi dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Studimet urbanistike të miratuara, që janë në fazën e zbatimit, si dhe rregulloret përkatëse të tyre duhet të rishikohen, me qëllim që të zbatohet zonimi arkeologjik i Vendbanimit të Komanit dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

URDHËR

Nr. 62, datë 17.9.2015

**PËR SHPALLJEN E STANDARDIT
KOMBËTAR TË KONTABILITETIT
TË OJF-VE DHE ZBATIMIN E
DETYRUESHËM TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe



pasqyrat financiare”, të ndryshuar, të vendimit nr. 2, datë 27.7.2015 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit “Për miratimin e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve, sipas materialeve përkatëse bashkëngjitur.

2. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit të OJF-ve bëhet i detyrueshëm për zbatim prej datës 1 janar 2016.

3. Deri në datën e zbatimit, me përdoruesit e tyre, të organizohen seminare dhe trajnime në nivel kombëtar dhe lokal.

4. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit të OJF-ve të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

5. Shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

VENDIM
Nr. 2, datë 27.7.2015

PËR MIRATIMIN E STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT TË OJF-VE

Në mbështetje të nenit 19, pikës 2.a, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar dhe të

vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, neni 16, pika 1 (h.i.j), Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, në mbledhjen e radhës të muajit korrik 2015, pas diskutimit mbi draftin e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse (SKK për OJF),

VENDOSI:

1. Të miratojë standardin Kombëtar të Kontabilitetit për OJF-të.

2. Të dërgojë Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për OJF-të për shpallje nga Ministri i Financave.

3. Menjëherë pas shpalljes së Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për OJF-të ta publikojë atë në faqen zyrtare të KKK (www.kkk.gov.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Pjesëmarrës në mbledhje:

1. Jorgji Bollano - kryetar
2. Flutura Kalemi-nënkryetar
3. Agim Binaj-anëtar
4. Limos Malaj- anëtar
5. Diana Lamani- anëtar
6. Anila Çili - anëtar
7. Fran Brahimi - anëtar

STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT TË ORGANIZATAVE JO FITIMPRURËSE (SKK PËR OJF-TË)

SEKSIONI I – TË PËRGJITHSHME

Përkufizimi i OJF-ve

1. Në kuptim të këtij Standardi, përkufizimi i organizatës jofitimprurëse është ai i dhënë në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”. Organizatat jofitimprurëse (më poshtë OJF) zhvillojnë veprimtari jofitimprurëse dhe në të mirë e interes të publikut, ashtu siç përcaktohet në ligjin e sipërpërmendur.

Objekti i këtij Standardi

2. SKK për OJF-të synohet të zbatohet nga të gjitha ato organizata që kanë statusin e njësisë ekonomike jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri. Janë objekt i këtij standardi fondacionet, shoqatat, qendrat, partitë politike, institucionet fetare, sindikatat dhe çdo organizatë tjetër e papërmendur në këtë paragraf, por që ka statusin e një organizate jofitimprurëse, përveç atyre OJF-ve apo disa prej veprimtarive të tyre, të cilat me ligj të veçantë, përjashtohen nga detyrimi për të ndërtuar dhe raportuar pasqyrat e tyre financiare.

Konsiderata të përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave financiare të OJF-ve

3. Ky Standard përshkruan objektivin e pasqyrave financiare të OJF-ve dhe cilësitë që e bëjnë informacionin e



	pasqyrave financiare të OJF-ve të dobishëm. Gjithashtu ky Standard jep konceptet dhe parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare të OJF-ve, për atë që ato ndryshojnë nga konceptet dhe parimet e ndërtimit të pasqyrave financiare të njësive ekonomike fitimprurëse. Konceptet dhe parimet e përgjithshme të ndërtimit të pasqyrave financiare të njësive ekonomike fitimprurëse, që nuk përmenden në këtë Standard, janë njësoj të vlefshme edhe për OJF-të (<i>shih tabelën korresponduese të paragrafëve</i>).
	Fusha e zbatimit
4.	Kërkesat e këtij Standardi do të zbatohen në të gjitha pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me këtë Standard nga ato organizata që kanë një identitet ligjor të veçantë, të cilat: <ol style="list-style-type: none"> 1. Janë krijuar për të kryer aktivitete të veçanta të një natyre bamirëse apo altruiste; 2. Nuk taten (për atë që nuk kryejnë aktivitet ekonomik fitimprurës); 3. Janë të ndaluar t'i shpërndajnë tepricat nga aktivitetet tek themeluesit dhe/ose anëtarët; dhe 4. Nuk zotërohen ose kontrollohen nga Qeveria.
	OBJEKTIVI I PASQYRAVE FINANCIARE TË OJF-VE
	Objektivi
5.	Objektivi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas këtij Standardi është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të Organizatave Jo Fitimprurëse, të dobishëm për qëllime të përgjegjësisë dhe vendimmarrjes së përdoruesve të këtyre pasqyrave financiare.
6.	Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të OJF-së, vetëm dhe vetëm nëse: <ol style="list-style-type: none"> a) ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përbajtjes së ngjarjeve ekonomike; b) përgatitja e tyre bazohet në vlerësime të arsyeshme e të bazuara (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme); dhe c) shënimet në pasqyrat financiare janë përgatitur me detaje të mjaftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të OJF-së, në mënyrë të tillë që lexuesit kompetentë të mund të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.
7.	Paraqitja e vërtetë dhe e besueshme nënkupton që: <ol style="list-style-type: none"> a) parimet bazë dhe kërkesat e tjera, të paraqitura nga neni 9 deri në 12 të ligjit të kontabilitetit nr. 9228, si dhe paragrafët 40-90 të SKK 1 <i>Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare</i>, janë përdorur si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare të OJF-ve; b) aktivet, detyrimet, aktivet neto, të ardhurat dhe shpenzimet, të paraqitura në pasqyrat financiare të OJF-ve, përmbushin kriteret e përkufizimeve të dhëna në këtë standard.
8.	Zbatimi me korrektësi i këtij Standardi në përgatitjen e pasqyrave financiare, në përgjithësi jep një pamje të vërtetë e të besueshme të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të OJF-së. Në raste shumë të rralla, kur drejtuesit e OJF-së mendojnë se zbatimi i paragrafëve të caktuar nuk bën të mundur dhënien e një pamjeje të vërtetë e të besueshme të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të OJF-së, atëherë drejtimi do të përgatisë pasqyrat financiare, sipas atyre parimeve që bëjnë të mundur një paraqitje të vërtetë e të besueshme dhe do të shpjegojë arsyet për moszbatimin e paragrafëve përkatëse të këtij Standardi, në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.
9.	Në rastet kur SKK për OJF nuk specifikon një politikë të caktuar kontabël, por kjo rregullohet nga një SKK/SNK/SNRF, atëherë këshillohet që të përdoret politika kontabël e përshkruar në SKK/SNK/SNRF si bazë për politikën kontabël. Megjithatë, aplikimi me zgjedhje i SKK-ve dhe SNK/SNRF-ve është i ndaluar.
10.	Nëse SKK për OJF, nuk adreson në mënyrë specifike një transaksion, ngjarje apo rrethanë tjetër, drejtimi i një OJF-je duhet të përdorë gjykimin e vet në zhvillimin dhe zbatimin e një politike kontabël që rezulton në informacion: <ol style="list-style-type: none"> a) të përshtatshëm për nevojat e vendimmarrjes së përdoruesve; dhe b) të besueshëm, për faktin se pasqyrat financiare: <ol style="list-style-type: none"> i) përfaqësojnë besnikërisht pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të OJF-së; ii) përfaqësojnë thelbin e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera, dhe jo thjesht formën ligjore; iii) janë neutrale, d.m.th. të lira nga paragjykimi; iv) të matura; dhe v) të plota në të gjitha aspektet materiale.
	Pozicioni financiar



11.	<p>Pozicioni financiar i një OJF-je është marrëdhënia e aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve neto në një datë të caktuar siç paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar. Këto përcaktohen si më poshtë:</p> <p>a) një aktiv është një objekt ose e drejtë e kontrolluar nga OJF si rezultat i ngjarjeve të kaluara, nga i cili pritet të rrjedhin në të ardhmen tek OJF-ja, përfitimet ekonomike ose forma të tjera të mundshme të përfitimeve;</p> <p>b) një detyrim është një detyrim aktual i OJF-së që rrjedh nga ngjarje të shkuara, shlyerja e të cilit pritet të rezultojë në një dalje në të ardhmen nga OJF-ja të përfitimeve ekonomike ose formave të tjera të mundshme të përfitimeve;</p> <p>c) aktivet neto përfaqësojnë aktivet e OJF-së mbasi zbriten të gjitha detyrimet e saj.</p>
12.	<p>Disa zëra që plotësojnë përkufizimin e një aktivi ose një detyrimi mund të mos njihen si aktive ose detyrime në pasqyrën e pozicionit financiar, sepse ato nuk plotësojnë kriteret për njohje dhënë në paragrafët 14 deri 26 të SKK 1 <i>Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare</i>. Në veçanti, pritshmëria që përfitimet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin tek ose nga një OJF, duhet të jetë mjaft e sigurt për të përmbushur kriterin e probabilitetit para njohjes së një aktivi ose detyrimi.</p>
	Përfitimet ekonomike ose format e tjera të përfitimeve, në të ardhmen
13.	<p>Aktiviteti i ofrojnë mundësi OJF-së për të arritur objektivat.</p> <p>Aktiviteti që përdoren për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve në përputhje me objektivat e OJF-së, por të cilat nuk gjenerojnë drejtpërdrejt flukëse hyrëse neto të mjeteve monetare, trajtohen si burime të formave të tjera të mundshme të përfitimeve në të ardhmen.</p> <p>Aktiviteti që përdoren për të gjeneruar flukse hyrëse neto të mjeteve monetare, trajtohen si burime të përfitimeve ekonomike në të ardhmen.</p>
	Performanca
14.	<p>Performanca tregohet nga marrëdhënia e të ardhurave dhe shpenzimeve të një OJF-je gjatë një periudhe raportuese. Ky standard kërkon që OJF-të të paraqesin performancën në pasqyrën e aktiviteteve.</p> <p>Të ardhurat dhe shpenzimet përcaktohen si vijon:</p> <p>(a) të ardhurat janë rritje të përfitimeve ekonomike ose formave të tjera të mundshme të përfitimeve, gjatë periudhës raportuese, të cilat rezultojnë si shtim i aktiveve ose si pakësim i detyrimeve;</p> <p>(b) shpenzimet janë zvogëlimet në përfitimet ekonomike ose formave të tjera të mundshme të përfitimeve, gjatë periudhës raportuese, të cilat rezultojnë si pakësim i aktiveve ose si shtim i detyrimeve.</p>
15.	Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve rezultojnë direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe e detyrimeve.
	PËRKUFIZIMET KRYESORE PËR ELEMENTET E PASQYRAVE FINANCIARE TË OJF-ve
16.	Aktiviteti, detyrimet, aktiviteti neto, të ardhurat dhe shpenzimet në pasqyrat financiare duhet të përmbushin kriteret e përkufizimeve të dhëna në këtë Standard. Kuptimet e këtyre përkufizimeve kryesore shpjegohen në paragrafët 17 deri 24 të këtij Standardi.
	Aktivi
17.	<p>Aktiviteti është një objekt ose e drejtë ekonomike e kontrolluar nga OJF-ja, i cili</p> <p>a) ka ardhur si rezultat i ngjarjeve të shkuara; dhe</p> <p>b) nga përdorimi, i të cilit priten në të ardhmen përfitime ekonomike ose forma të tjera të mundshme të përfitimeve.</p>
	Detyrimet
18.	<p>Detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar të OJF-së janë detyrime aktuale të cilat:</p> <p>a) kanë lindur nga ngjarje të shkuara; dhe</p> <p>b) shlyerja e tyre pritet të shoqërohet në të ardhmen me daljen e përfitimeve ekonomike apo të llojeve të tjera të përfitimeve të mundshme.</p>
	Aktiviteti neto
19.	<p>Aktiviteti neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të OJF-së në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Aktiviteti neto, mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur nga donatori, ndahen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - aktive neto të kufizuara, dhe - aktive neto të pakufizuara;



	Aktivet neto të kufizuara
20.	Aktivet neto të kufizuara janë burime të kufizuara nga donator/ët. Kufizimet e donatorëve mund të kërkojnë që burimet të përdoren në një periudhë të mëvonshme ose pas një date të caktuar (kufizim në kohë), ose ato burime të përdoren për një qëllim të caktuar (kufizimi i qëllimit), ose të dyja bashkë, p.sh. dhuratat në mjete monetare apo aktive të tjera me përcaktimin që të investohen për të siguruar një burim të ardhurash për një afat të caktuar dhe gjithashtu, kjo e ardhur të përdoret për një qëllim të caktuar. Sa më sipër janë kufizime <i>në kohë</i> dhe <i>në qëllim</i> . Këto dhurata shpesh quhen <i>dhurata me afat</i> .
	Aktivet neto të pakufizuara
21.	Aktivet neto të pakufizuara zakonisht janë rezultat i ofrimit të shërbimeve, prodhimit dhe shpërndarjes së mallrave, marrjes së kontributeve të pakufizuara, marrja e dividendëve apo interesave në aktive që gjenerojnë të ardhura, pakësuar me shpenzimet që ndodhin gjatë ofrimit të shërbimeve, prodhimit dhe shpërndarjes së mallrave, krijimit të fondeve dhe realizimit të funksioneve administrative.
22.	Të vetmet kufizime në përdorimin e aktiveve neto të pakufizuara janë ato kufizime që burojnë nga natyra e vetë organizatës, mjedisi në të cilin ajo operon dhe qëllimet e specifikuar në statutin e themelimit të saj apo në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore si dhe kufizime që burojnë nga marrëveshjet kontraktuale me furnitorët, kreditorët dhe të tjerë palë të lidhura me organizatën në rrjedhën e aktivitetit të saj.
	Të ardhurat
23.	Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse, gjatë periudhës së raportimit, të përfitimeve ekonomike apo formave të tjera të mundshme të përfitimeve , që rezultojnë në rritjen e aktiveve neto të pakufizuara.
	Shpenzimet
24.	Shpenzimet janë flukse dalëse, gjatë periudhës raportuese, të përfitimeve ekonomike apo formave të tjera të mundshme të përfitimeve , që rezultojnë në pakësimin e aktiveve neto të pakufizuara.
	SEKSIONI II
	PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE TË OJF-ve
25.	Ky Seksion përcakton parimet për hartimin e pasqyrave financiare të organizatave jo fitimprurëse. Pasqyrat financiare të OJF-ve përbëhen nga: - pasqyra e pozicionit financiar, - pasqyra e aktiviteve, dhe - pasqyra e fluksit të mjeteve monetare. Organizatave jo fitimprurëse japin në shënimet shpjegues informacione të tjera shtesë të nevojshme për të kuptuar llojin e aktiviteve dhe shërbimeve që kryejnë.
26.	Organizatave jofitimprurëse që kanë shifrën e aktivitetit ose shifrën e të ardhurave më të madhe se 5 milionë lekë, zbatojnë kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuar dhe ndërtojnë të gjitha pasqyrat financiare sipas paragrafit 25. OJF-të të cilat nuk plotësojnë këtë kriter zbatojnë kontabilitetin mbi baza monetare dhe ndërtojnë vetëm pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të shoqëruar me shënimet shpjeguese lidhur me llojin e aktiviteve apo shërbimeve që ofron.
	Qëllimi i pasqyrave financiare
27.	Qëllimi kryesor i pasqyrave financiare është të ofrojë informacionin e duhur në plotësim të interesave të përbashkët të donatorëve, anëtarëve, kreditorëve dhe kujtdo pale tjetër, e cila ofron burime për OJF-në. Këta përdorues të jashtëm të pasqyrave financiare kanë interesa të përbashkët në vlerësimin e: a) shërbimeve që organizata ofron dhe aftësisë së saj për të vazhduar me ofrimin e këtyre shërbimeve dhe b) mënyrës sesi menaxheri delegon përgjegjësitë e tij dhe bashkëpunon me të tjerët c) aspekte të tjera të performancës së organizatës.
28.	Në mënyrë specifike, qëllimi i pasqyrave financiare, përfshirë shënimet shpjeguese, është të japë informacion rreth: a) shumës dhe natyrës së aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve neto të OJF-së; b) efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe rrethanave të tjera, të cilat çojnë në ndryshime të shumës dhe natyrës së aktiveve neto; c) shumave dhe llojeve të flukseve hyrëse dhe dalëse të burimeve ekonomike gjatë periudhës si dhe marrëdhënien midis këtyre flukseve; d) faktit sesi i siguron dhe shpenzon paratë (përfshirë huat dhe shlyerjen e tyre) si dhe faktorëve të tjerë që ndikojnë likuiditetet e OJF-së; e) përpjekjeve për ofrimin e shërbimeve nga një OJF. Pasqyrat financiare individuale ofrojnë informacion të ndryshëm nga njëra tjetra por informacioni i secilës pasqyrë plotëson atë të pasqyrave të tjera.
	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
	Qëllimi dhe objekti i pasqyrës së pozicionit financiar
29.	Qëllimi kryesor i pasqyrës së pozicionit financiar është të japë informacionin e duhur mbi aktivet, detyrimet



	dhe aktivet neto të OJF-së si dhe marrëdhëniet e tyre me njëra tjetrën në një moment të caktuar kohe. Informacioni i dhënë në pasqyrën e pozicionit financiar i përdorur së bashku me informacionin e dhënë në shënimet shpjeguese apo informacionin e pasqyrave të tjera financiare, ndihmon donatorët, anëtarët, kreditorët dhe të tjerë përdorues të vlerësojnë a) aftësinë e OJF-së për të vazhduar ofrimin e shërbimeve dhe b) likuiditetin e OJF-së, fleksibilitetin financiar, aftësinë për të shlyer detyrimet dhe nevojat për financime të jashtme.
30.	Pasqyra e pozicionit financiar ka si totale OJF-në si një e tërë duke paraqitur shumat e aktiveve totale, detyrimeve totale dhe aktiveve neto.
	Klasifikimi I aktiveve dhe detyrimeve (shih shtojcën I)
31.	Pasqyra e pozicionit financiar, përfshirë shënimet shpjeguese për pasqyrat, jep informacionin e duhur rreth likuiditetit, fleksibilitetit financiar dhe marrëdhënies mes aktiveve dhe detyrimeve të OJF-së. Ky informacion jepet në pasqyrë duke i bashkuar aktivet (detyrimet) me karakteristika të njëjta në grupime të arsyeshme homogjene.
32.	Grupime të tilla mund të jenë: paraaja dhe ekuivalentët e saj, llogari të arkëtueshme dhe dëftesa të arkëtueshme nga pacientët, studentët, anëtarët apo përfituesit e tjerë të shërbimeve; inventarët e materialeve dhe furniturave të tjera të konsumueshme; depozita dhe parapagime për qira, siguracione apo shërbime të tjera; letrat me vlerë të tregtueshme dhe aktive të tjera financiare të mbajtura për qëllime afatgjatë; toka, ndërtesa, pajisje dhe të tjera aktive afatgjata të përdorshme për të ofruar mallra dhe shërbime.
33.	Mjetet monetare apo aktive të tjera të marra kundrejt një kufizimi të vendosur nga donatori, kufizim që përcakton përdorimin e tyre në terma afatgjatë, nuk mund të paraqitet në të njëjtin grup me mjetet monetare dhe aktivet e tjera të cilat janë të pakufizuara dhe të vlefshme për përdorim afatshkurtër.
34.	Informacioni mbi likuiditetin duhet të jepet sipas kërkesave të mëposhtme: a) Renditja e aktiveve bëhet sipas afatit të tyre për t'u konvertuar në para' dhe renditja e detyrimeve sipas afateve të maturimit apo nevojës për të përdorur para' për shlyerjen e tyre; b) Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve si afatshkurtra dhe afatgjata bëhet sipas kufizimeve të bëra në SKK 1 <i>Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> ;
35.	Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet dhënë informacioni i duhur mbi likuiditetin ose afatet e maturimit të aktiveve dhe detyrimeve, përfshirë kufizimet në përdorimin e aktiveve të veçanta.
	Klasifikimi i aktiveve neto si të kufizuara apo të pakufizuara nga donatorët
36.	Pasqyra e pozicionit financiar e përgatitur nga një OJF paraqet shumat e secilës prej dy klasave të aktiveve neto: – aktive neto të kufizuara, dhe - aktive neto të pakufizuara; mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur nga donatori.
	Aktivitet neto të kufizuara
37.	Brenda kategorisë së aktiveve neto të kufizuara, duhet të paraqiten si zëra të veçantë, në pasqyra apo në shënime shpjeguese, si më poshtë: a) aktivet, si p.sh, toka apo veprat e artit të dhuruara, me përcaktimin që të përdoren për qëllime specifike, të ruhen dhe të mos shiten, ose b) aktive të dhuruara me qëllim që të investohen për të siguruar një burim të përhershëm të ardhurash; Pika b, rezulton nga dhurata apo trashëgimi që krijojnë fonde të përhershme të dhuruara.
38.	Në mënyrë të ngjashme, paraqiten në zëra të veçantë brenda aktiveve neto të kufizuara ose në shënime shpjeguese: a) ndihmat për aktivitete operative të veçanta, b) investimet për një afat të përcaktuar, c) përdorimet në një periudhë të ardhshme të përcaktuar, ose d) blerjet e aktiveve afatgjata.
	Aktivitet neto të pakufizuara
39.	Informacioni rreth kufizimeve kontraktuale të cilat janë të konsiderueshme dhe të rëndësishme, përfshirë ekzistencën e angazhimeve për të marrë hua, zakonisht paraqitet në shënime shpjeguese. Në mënyrë të ngjashme, informacioni rreth kufizimeve të vetëvendosura që konsiderohet i rëndësishëm, përfshirë informacionin mbi ndonjë vendim të mbështetur në vullnetin e lirë të bordit drejtues të organizatës për të krijuar një pjesë të aktiveve neto të pakufizuara sipas funksionit si dhurata (<i>ndonjëherë të quajtura dhurata të krijuara nga Bordi</i>), mund të jepet në shënime ose tek vetë pasqyrat financiare.
	PASQYRA E AKTIVITETEVE
	Qëllimi dhe objekti i pasqyrës së aktiviteteve
40.	Për OJF-të, në dallim nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve që aplikohet tek njësitë e tjera ekonomike,



	përdoret termi “Pasqyra e aktiviteteve”.
41.	Qëllimi kryesor i pasqyrës së aktiviteteve është të japë informacionin e duhur mbi: a) efektet rreth transaksioneve të ngjarjeve apo rrethanave të tjera që çojnë në ndryshimin e shumave dhe natyrës së aktiveve neto; b) marrëdhëniet e këtyre transaksioneve, ngjarjeve e rrethanave të tjera me njëra tjetrën; dhe c) si përdoren burimet e organizatës për të ofruar programe apo shërbime të ndryshme.
42.	Informacioni i paraqitur në pasqyrën e aktiviteteve i përdorur së bashku me shënimet shpjeguese apo informacionin e pasqyrave të tjera, ndihmon donatorët, kreditorët e të tjerë përdorues që: 1) të vlerësojnë performancën e organizatës gjatë periudhës; 2) vlerësojnë përpjekjet e organizatës për të ofruar shërbime dhe aftësinë e saj për të vazhduar në ofrimin e shërbimeve; 3) vlerësojë sesi drejtuesit e organizatës delegojnë përgjegjësitë dhe bashkëpunojnë me të tjerët; 4) aspekte të tjera të performancës së organizatës.
43.	Pasqyra e aktiviteteve e hartuar nga një OJF fokusohet në organizatën si një e tërë dhe paraqet ndryshimet në aktivet neto për periudhën. Në këtë pasqyrë përdoret termi përshkrues <i>ndryshimi në aktivet neto</i> . <i>Ndryshimi në aktivet neto</i> paraqitur në pasqyrën e aktiviteteve artikullohet në aktivet neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar.
	Ndryshimet në zërat e aktiveve neto
44.	Pasqyra e aktiviteteve paraqet shumat e ndryshimeve të aktiveve neto të kufizuara dhe të pakufizuara, për periudhën. Të ardhurat, shpenzimet, fitimet dhe humbjet shtojnë ose pakësojnë aktivet neto dhe do të klasifikohen si në paragrafët më poshtë.
45.	Ngjarjet e tjera si p.sh., përfundimi i kufizimit të vendosur nga donatori, i cili në të njëjtën kohë rrit një zë të aktiveve neto dhe ul një tjetër, duhen paraqitur si zëra të veçantë.
46.	Informacioni mbi të ardhurat, shpenzimet, fitimet dhe humbjet dhe riklasifikimet, zakonisht jepet në mënyrë të agreguar duke bashkuar në një zë elemente që kanë karakteristika të ngjashme brenda një grupi të arsyeshëm homogjen.
	Klasifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, fitimeve dhe humbjeve (shih shtojcën 2)
47.	Pasqyra e aktiviteteve paraqet të ardhurat si rritje në aktivet neto të pakufizuara, përveç rasteve kur përdorimi i aktiveve të marra kufizohet nga kufizimi i vendosur nga donatori. Për shembull, tarifat nga ofrimi i shërbimeve dhe të ardhurat nga investimet zakonisht janë të pakufizuara; megjithatë, të ardhurat nga aktivet neto të kufizuara në periudha afatgjata ose dhuratat me afat mund të jenë të kufizuara nga donatori dhe rrisin aktivet neto të kufizuara.
48.	Sugjerohet që të ardhurat të paraqiten sipas ndarjeve më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ardhura nga tarifat e anëtarësimin 2. Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare 3. Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit 4. Të ardhura nga investimet apo dhurimet 5. Tarifat për shërbimet 6. Të ardhura nga aktivitetet tregtare
49.	Pasqyra e aktiviteteve i paraqet shpenzimet si pakësim i aktiveve neto të pakufizuara.
50.	Nëse OJF-të zhvillojnë aktivitet ekonomik tregtar, parimet e raportimit financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhen me këto të ardhura të aktivitetit tregtar, janë të njëjta me ato për njësitë ekonomike fitimprurëse. Zërat e tyre paraqiten në një grup më vete, në pasqyrën e aktiviteteve, të ndërtuar sipas funksionit.
51.	Në mungesë të një kufizimi nga donatori apo të ndonjë situatë ku marrja e kontributeve ka kufizime për përdorim të vendosur nga donatori, kontributet e tjera paraqiten si të ardhura apo fitime të pakufizuara (ndihma të pakufizuara) të cilat çojnë në shtimin e aktiveve neto të pakufizuara. Kontributet e kufizuara nga donatorët paraqiten si të ardhura apo fitime të kufizuara (ndihma të kufizuara) të cilat çojnë në shtimin e aktiveve neto të kufizuara në periudha afatgjatë, në varësi kjo të llojit të kufizimit.
52.	Megjithatë, kontributet e kufizuara nga donatori, kufizimet e të cilit plotësohen në të njëjtën periudhë raportuese, mund të paraqiten si ndihma të pakufizuara, me detyrimin që organizata të zbatojë në mënyrë të qëndrueshme nga periudha në periudhë, në pasqyra dhe në shënime, të njëjtat politika kontabël.
53.	Pasqyra e aktiviteteve paraqet fitimet dhe humbjet e njohura nga investimet dhe aktivet e tjera (ose detyrimet) si një shtim ose pakësim në aktivet neto të pakufizuara përveç rasteve kur përdorimi i tyre është në mënyrë të përhershme ose të përkohshme i kufizuar nga donatori ose ligji, p.sh, fitimet neto nga investimet në aktive, për aq sa janë njohur në pasqyrat financiare, paraqiten si rritje në aktivet neto të pakufizuara, përveç rasteve kur përdorimi i tyre kufizohet për një qëllim të veçantë apo periudhë të ardhshme. Nëse Bordi drejtues përcakton se ligji i kërkon organizatës të mbajë në mënyrë të përhershme një pjesë të fitimeve mbi investimet në aktive të fondeve të dhuruara, ajo shumë do të paraqitet si një shtim në aktivet neto të kufizuara në periudha afatgjata.
54.	Klasifikimi i të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve dhe humbjeve, brenda zërave të aktiveve neto nuk përjashton klasifikime të mëtejshme brenda pasqyrës së aktiviteteve. Për shembull, brenda një zëri apo zërave të ndryshimeve në aktivet neto, një OJF mund të klasifikojë nënkategori të tipit operative dhe jo operative,



	shpenzuese dhe jo shpenzuese, të fituara dhe të pafituara, periodike dhe jo periodike, apo riklasifikime të tjera. Kjo pasqyrë as i inkurajon dhe as i dekurajon klasifikimet e mëtejshme.
	Informacion mbi shumat bruto të të ardhurave dhe shpenzimeve
55.	Për të kuptuar marrëdhëniet mes aktiviteteve dhe operacioneve kryesore apo të përgjithshme të një OJF-je, pasqyra e aktiviteteve paraqet shumat bruto të të ardhurave dhe shpenzimeve, megjithatë, të ardhurat nga investimet paraqiten për shumën neto me shpenzimet korresponduese si në rastin e tarifave të kujdestarisë dhe tarifave për këshillimet në investime duke konsideruar të mirëqenë faktin se shuma e shpenzimeve është paraqitur dhe shpjeguar në pasqyrën financiare të aktiviteteve ose në shënimet shpjeguese.
56.	Pasqyra e aktivitetit mund të paraqesë fitimet dhe humbjet si shuma neto nëse ato rezultojnë nga transaksione periferike ose të rastësishme apo nga ngjarje dhe rrethana të tjera që nuk janë nën kontrollin e organizatës dhe drejtimit të saj. Informacioni rreth këtyre shumave neto përgjithësisht është i mjaftueshëm për të kuptuar aktivitetet e organizatës. Për shembull, një OJF që shet tokën dhe ndërtesat, të cilat nuk i shërbejnë më për zhvillimin e aktiviteteve, zakonisht e raporton këtë transaksion si një fitim ose humbje neto pa i paraqitur si të ardhura bruto nga shitja nga njëra anë, dhe shpenzime të vlerës së mbetur të tokës dhe ndërtesës së shitur nga ana tjetër.
57.	Shuma neto e transaksioneve periferike e përdorur së bashku me informacionin e dhënë në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare është e mjaftueshme për të vlerësuar sesi OJF-ja i përdor burimet e saj dhe sesi menaxherët e drejtojnë këtë organizatë.
	Informacion mbi angazhimin e organizatës për ofrimin e shërbimit
58.	Për të ndihmuar donatorët, kreditorët dhe të tjerë përdorues në vlerësimin e angazhimit të organizatës për të ofruar shërbime, përfshirë kostot e këtyre shërbimeve dhe shfrytëzimit të burimeve të përdorur për këto shërbime, pasqyra e aktiviteteve ose shënimet shpjeguese duhet të japin informacion rreth shpenzimeve të raportuara të klasifikuara sipas funksionit si p.sh, kategoritë kryesore të programeve të shërbimeve dhe aktivitetet ndihmëse.
59.	Organizatave vullnetare për shëndetin dhe mirëqenien duhet ta paraqesin këtë informacion si dhe një informacion tjetër për shpenzimet duke i klasifikuar ato sipas natyrës si p.sh, paga, qera, shpenzime energjie, shpenzime interesi, amortizim, shpërblime dhe grante tek të tjerë, tarifa profesionale e të tjera shpenzime si këto në një format matrice në një pasqyrë financiare të veçantë. OJF-të e tjera janë të inkurajuara por jo të detyruara ta paraqesin informacionin për shpenzimet duke i klasifikuar ato sipas natyrës.
60.	Programet e shërbimeve janë aktivitete që rezultojnë nga ofrimi dhe shpërndarja e mallrave dhe shërbimeve tek përfuturit, klientët apo anëtarët që përmbushin qëllimin ose misionin për të cilin kjo organizatë ekziston. Këto shërbime janë qëllimi kryesor dhe objektivi kryesor i vetë organizatës dhe shpesh lidhen me programe të ndryshme aktivitetshe p.sh, një universitet i madh mund të ketë programe për udhëzimin e studentëve, kërkimin dhe kujdesin për shëndetin mes të tjerash. Në mënyrë të ngjashme një organizatë vullnetare për shëndetin dhe mirëqenien mund të ketë programe për shëndetin apo shërbimin në familje, kërkimin, mbështetjet në rast fatkeqësie dhe edukimin publik mes të tjerash.
61.	Aktivitetet mbështetëse janë të gjithë ato aktivitete të një OJF-je që nuk janë pjesë e programit të shërbimeve. Zakonisht, ato përfshijnë aktivitete të drejtimit të përgjithshëm, aktivitete për sigurimin e fondeve dhe aktivitete për zhvillimin e shtimit e anëtarësisë.
62.	Aktivitetet e drejtimit të përgjithshëm përfshijnë mbikëqyrjen, drejtimin e aktiviteteve të biznesit, kontabilitetin, buxhetimin, financimin dhe aktivitete të tjera administrative të lidhura me to dhe çdo shpenzim tjetër të lidhur me menaxhimin dhe administrimin që nuk lidhet me drejtimin e drejtpërdrejtë të programit të shërbimeve apo aktiviteteve të mbledhjes së fondeve.
63.	Aktivitetet për mbledhje fondesh përfshijnë publicitetin dhe fushatat për mbledhje fondesh; mirëmbajtje e listave të donatorëve; organizimin e aktiviteteve specifike për mbledhje fondesh; hartimin e shpërndarjen e materialeve udhëzuese dhe trajnuese në lidhje me mbledhjen e fondeve; dhe organizimin e aktiviteteve të tjera ku përfshihen bashkëpunime dhe kontribute nga individë, fondacione, agjenci të ndryshme qeveritare dhe të tjera.
64.	Aktivitetet lidhur me zhvillimin e anëtarësisë përfshijnë aktivitete që sensibilizojnë anëtarësinë e mundshme, marrëdhëniet mes anëtarëve dhe aktivitete të ngjashme.
	PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE
	Qëllimi i pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare
65.	Në rastin e OJF-ve, donatorët përfaqësojnë investitorët, kreditorët dhe të tjera burime, terma të përdorur në rastin e njësisë ekonomike me qëllim fitimi. Flukset e mjeteve monetare ndahen në flukse nga aktivitetet e shfrytëzimit, aktivitetet investuese dhe aktivitetet financiare.
66.	Në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, në rastin e OJF-ve në flukset e aktiviteteve investuese paraqiten kontributet e kufizuara nga donatorët për qëllime investimi: - të blerjes, ndërtimit apo përmirësimeve të tokës, ndërtesave dhe makinerive ose aktiveve të tjera



	afatgjata; - të krijimit ose shtimit të një dhurimi të përhershëm ose me afat.
67.	Interesat dhe dividendët, të cilët janë të kufizuar nga donator për qëllime në terma afatgjatë, nuk përfshihen në arkëtimet në aktivitetet e shfrytëzimit.
68.	Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare të OJF-ve është e lejuar të ndërtohet në metodën indirekte ose direkte, por inkurajohet të përgatitet kjo e fundit.
	SEKSIONI III
	Kontabilizimi dhe raportimi i kontributeve të marra dhe të dhëna
69.	Ky seksion jep parimet e kontabilizimit dhe raportimit të kontributeve të marra dhe të dhëna. Kontabiliteti i kontributeve është një çështje që i përket OJF-ve sepse kontributet janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për këto organizata. Ky seksion gjithashtu, jep parimet për njohjen e përfundimit të kufizimeve mbi kontributet e marra dhe për kontabilizimin e koleksioneve në formën e veprave të artit, thesareve historike dhe aktiveve të ngjashme të siguruar si kontribute apo forma të tjera.
	Objekti
70.	Ky seksion aplikohet për kontributet në mjete monetare apo aktive të tjera, përfshirë premtimet për të dhënë; nuk përfshihen në këtë seksion transferimet e aktiveve që në përmbajtje janë blerje mallrash apo shërbimesh (transaksione shkëmbimi) ku secila palë nga njëra anë merr dhe nga ana tjetër angazhon burime. Megjithatë, nëse një OJF transferon vullnetarisht aktive tek një njësi tjetër apo realizon shërbime për një njësi tjetër në këmbim të aktiveve të tjera, me një vlerë shumë më të ulët, dhe ku nuk përfshihen të drejta apo privilegje të deklaruara, kontributi i nënkuptuar në këtë transaksion është brenda objektit të këtij seksioni.
71.	Ky seksion nuk aplikohet për transferime të aktiveve në të cilat OJF-ja vepron si një agjent, i mirëbesuar apo ndërmjetës, pra jo si një donator apo përfitues donacionesh. Gjithashtu, nuk aplikohet në rastet e përjashtimeve nga taksat, nxitësve tatimorë, zbritjes së taksave apo për transferime të aktiveve nga organizatat qeveritare tek njësitë ekonomike të biznesit.
	Përkufizimet
72.	Një kontribut është një transferim i pakushtëzuar i mjeteve monetare apo aktiveve të tjera tek një OJF ose një shlyerje apo shuarje e detyrimeve të saj në një transferim jo reciprok vullnetar nga një OJF tjetër me përjashtim të rasteve kur vepron si një pronar. Aktivitetet e tjera përfshijnë letrat me vlerë, tokën, ndërtesat, përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve, materialeve dhe furniturave të konsumueshme, aktiveve jomateriale, shërbimeve dhe premtimeve të pakushtëzuara për t'i dhënë ato zëra në të ardhmen.
73.	Një premtim për të dhënë është një marrëveshje verbale ose e shkruar për të kontribuar në para ose aktive të tjera tek një njësi tjetër; megjithatë, që të njihet në pasqyrat financiare duhet të ekzistojë një evidencë e mjaftueshme, në formën e një dokumentacioni të verifikueshëm që ky premtim është bërë dhe njëkohësisht përfituar nga pala tjetër. Një komunikim që nuk tregon qartë nëse është një premtim, konsiderohet një premtim i pakushtëzuar për të dhënë nëse tregon një synim të pakushtëzuar për të dhënë, i cili është ligjërish i detyrueshëm.
74.	Një kusht i vendosur nga donatori në një transferim të aktiveve ose një premtim për të dhënë, specifikon një ngjarje të ardhshme të pasigurt, ndodhja apo dështimi i së cilës i jep premtuesit të drejtën e rikthimit të aktiveve të transferuara ose e çliron premtuesin nga detyrimi i tij për të transferuar aktivitetet e premtuara.
75.	Në të kundërt, një kufizim i vendosur nga donatori kufizon përdorimin e aktiveve të kontribuara; kufizimi specifikon një përdorim më të veçantë krahasuar me përdorimet e aktiveve të tjera që rezultojnë nga natyra e organizatës, mjedisi në të cilin operon dhe qëllimet e specifikuar në nenet e statutit ose akte të tjera ligjore e nënligjore.
	Kontributet e marra
76.	Kontributet e marra duhet të njihen si të ardhura ose fitime në periudhën kur merren dhe si aktive, pakësim të detyrimeve apo shpenzimeve në varësi të formës së përfitimit të marrë. Kontributet e marra maten me vlerën e tyre të drejtë. Kontributet e marra nga OJF paraqiten si ndihma të kufizuara ose të pakufizuara.
	Kontributet në formën e shërbimeve
77.	Kontribute në shërbime do të njihen nëse shërbimet e përfituara (a) krijojnë ose shtojnë aktive jofinanciare ose (b) kërkojnë aftësi të specializuara të ofruara nga individë që i kanë këto aftësi dhe nëse nuk përfitoheshin si donacion do duhej të bliheshin. Shërbimet që kërkojnë aftësi të specializuara ofrohen nga arkitektë, kontabilistë, hekurkthyesit, doktorët, elektrikistët, avokatët, infermierët, hidraulikët, mësuesit, zejtarët dhe profesionistë të tjerë.
78.	Kontributet në shërbime dhe premtimet për të dhënë shërbime që nuk plotësojnë kriteret e mësipërme nuk do të njihen në pasqyrat financiare.
79.	Një OJF që merr kontribute në shërbime duhet të përshkruajë programet apo aktivitetet për të cilat janë përdorur këto shërbime përfshirë natyrën dhe shkallën e kontributit në shërbimet e marra për periudhën si dhe shumën e njohur si të ardhur për periudhën.



80.	OJF-të janë të inkurajuara të shpjegojnë vlerën e drejtë të kontributeve të marra në formën e shërbimeve, por jo të njohur si të ardhur, nëse një gjë e tillë është e mundur.
	Kontribute në koleksione të mbledhura
81.	Një OJF nuk i njej kontributet në formën e veprave të artit, thesareve historike dhe aktiveve të ngjashme nëse objektet e dhuruara i shtohen koleksioneve që plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) Mbahen për ekspozime në publik, edukim ose për kërkime në përmirësim të shërbimit ndaj publikut dhe jo për përfitime financiare; b) Janë të mbrojtura, mbahen të papërdorura, janë në kujdestari dhe të ruajtura; c) Janë subjekt i një politike të organizatës që kërkon që të ardhurat nga shitja e këtyre koleksioneve të përdoren për të blerë koleksione të tjera.
82.	Për qëllime të aplikimit për herë të parë të këtij seksioni, OJF-të janë të inkurajuara: a) të kapitalizojnë në mënyrë retrospektive koleksionet e blera në periudha të mëparshme, ose b) të kapitalizojnë koleksionet në mënyrë prospektive. Kapitalizimi i koleksioneve me përzgjedhje nuk lejohet.
83.	Kontributet në koleksione do të njihen si të ardhura dhe fitime nëse koleksionet kapitalizohen dhe e kundërta. Një OJF që nuk njej dhe nuk kapitalizon koleksionet apo që i kapitalizon koleksionet në mënyrë prospektive do të japë shënime shpjeguese shtesë në pasqyrën e shënimeve shpjeguese.
	Raportimi i OJF-ve
84.	Një OJF duhet t'i paraqesë të ndara kontributet e marra me kufizim dhe ato pa kufizime nga donatori. Një kufizim në përdorimin e aktiveve të kontribuara vjen si rezultat ose i një kërkesë eksplicite të donatorit ose nga një rrethanë që ka lidhje me marrjen e kontributit, e cila e bën të qartë kufizimin e nënkuptuar të donatorit në përdorimin e aktivitetit. Kontributet me kufizim nga donatori do të paraqiten si ndihma të kufizuara; megjithatë, kontributet e kufizuara nga donatori, në rastin kur kufizimet plotësohen brenda së njëjtës periudhë raportuese, mund të paraqiten si ndihma të pakufizuara me kushtin që OJF-ja të ketë një raportim të qëndrueshëm nga periudha në periudhë dhe t'i shpjegojë politikën e veta kontabël.
85.	Ndihmat ose mbështetjet e kufizuara çojnë në shtimin e aktiveve neto të kufizuara. Kontributet pa kufizime nga donatori do të raportohen si ndihma të pakufizuara që çojnë në shtimin e aktiveve neto të pakufizuara.
86.	Marrja e premtimeve të pakushtëzuara për të dhënë me pagesa që i përkasin periudhave të ardhshme do të raportohen si një ndihmë e kufizuar përveç kur një kufizim i vendosur nga donatori ose një rrethanë në lidhje me marrjen e këtij premtimi e bën të qartë faktin se donatori e ka destinuar aktivin e dhuruar për t'u përdorur në aktivitetet e periudhës aktuale p.sh, marrja e premtimeve të pakushtëzuara për të dhënë para në vitet e ardhshme zakonisht çon në shtimin e aktiveve neto të kufizuara.
87.	Dhurimet në formën e aktiveve afatgjata materiale të marra pa ndonjë marrëveshje se për çfarë afati kohor do të përdoren, duhet të paraqiten si ndihma të kufizuara nëse kjo është politika kontabël e organizatës për të nënkuptuar një kufizim në kohë që përfundon përtej jetës së dobishme të aktivitetit afatgjatë material. OJF-të që adoptojnë politika kontabël që përfshijnë kufizime në terma kohorë, duhet gjithashtu të aplikojnë një kufizim kohor edhe mbi aktivitet afatgjatë materiale të siguruar si dhurata apo të blera me para' apo aktive të tjera të kufizuara për blerjen e këtyre aktiveve. Në mungesë të një politike të tillë apo kufizimeve të tjera të vëna nga donatori për përdorimin e aktivitetit, dhurimet në formën e aktiveve afatgjata materiale duhet të paraqiten si ndihma të pakufizuara. Një OJF duhet të shpjegojë politikën e saj kontabël në pasqyrën e shënimeve shpjeguese.
	Përfundimi i kufizimeve të vëna nga donatori
88.	Një OJF do të njohë përfundimin e një kufizimi të vënë nga donatori mbi një kontribut në periudhën në të cilën kufizimi përfundon. Një kufizim përfundon kur afati i caktuar ka mbaruar, kur qëllimi për të cilin ishte kufizuar plotësohet, apo të dyja rastet së bashku. Nëse një shpenzim ndodh për një qëllim për të cilin, bashkërisht janë të vlefshëm edhe aktivitet neto të pakufizuara dhe ato të kufizuara, atëherë kufizimi i vënë nga donatori është plotësuar deri në masën e shpenzimit të ndodhur përveç rastit kur shpenzimi është bërë për një qëllim që i atribuohet një burimi specifik të jashtëm të të ardhurave. Për shembull, një shpenzim nuk plotëson një kufizim ekzistues të vënë nga donatori nëse ky shpenzim ka ndodhur për një qëllim që është drejtpërdrejt i lidhur me dhe i rimbursuar nga një marrëveshje shkëmbimi e sponsorizuar ose një shpërblim i kushtëzuar nga një agjenci qeveritare, fondacion privat, apo të tjera. Përfundimet e kufizimeve të vëna nga donatori që njëkohësisht shtojnë një klasë të aktiveve neto dhe pakësojnë një klasë tjetër (riklasifikim) paraqiten të ndara nga transaksione të tjera.
	Kontributet e dhëna
89.	Kontributet e dhëna do të njihen si shpenzime në periudhën kur janë dhënë dhe si pakësim i aktiveve apo shtim i detyrimeve, në varësi kjo të formës së përfitimit të dhënë. Për shembull, dhurimet e bëra nga zërat e inventarëve që mbahen për shitje, njihen si pakësim i aktiveve (inventarëve) dhe si shpenzime për kontribute. Ndërsa premtimet e pakushtëzuara për të dhënë para njihen si detyrime të pagueshme dhe si shpenzime për kontribute. Kontributet e dhëna do të maten me vlerën e drejtë të aktivitetit të dhënë ose, nëse janë në formën e shuarjes së një detyrimi të përfituesit të donacionit, do të maten me vlerën e drejtë të detyrimit të fshirë.



Matja me vlerën e drejtë	
90.	Çmimet e kuotuarra të tregut, nëse ka të tilla, janë evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të aktiveve monetare ose jomonetare, përfshirë shërbimet. Nëse çmimet e tregut nuk gjenden, vlera e drejtë mund të vlerësohet mbështetur në çmimet e tregut për aktive të ngjashme, çmuarje të pavarura, apo teknika të tjera vlerësimi si p.sh, vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare. Kontributet në shërbime që krijojnë ose shtojnë aktivet jofinanciare mund të maten duke iu referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të marra ose vlerës së drejtë të aktivitetit apo shtesës së tij, si rezultat i shërbimit të marrë. Një pasiguri e qenësishme rreth ekzistencës së vlerës së aktivitetit, mund të çojë në mosnjohjen e një shërbimi të marrë ose të dhënë.
91.	Vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare, duke përdorur një normë skontimi në përpjesëtim të drejtë me riskun e përfshirë, është një matje shumë e përshtatshme e vlerës së drejtë të një premtimi të pakushtëzuar për të dhënë para ⁷ . Interesi i përlllogaritur (rritës) do të kontabilizohet nga përfituesi si një e ardhur nga kontributi dhe nga donatori si një shpenzim për kontribute. OJF-të do të paraqesin të ardhurat nga kontributet si një rritje në aktivet neto të kufizuara nëse premtimi për të dhënë është i kufizuar nga donatori.
Premtimet e kushtëzuara për të dhënë	
92.	Premtimet e kushtëzuara për të dhënë, të cilat varen nga ndodhja në të ardhmen e një ngjarje të caktuar të pasigurt, e lidhur me premtuesin, do të njihen kur kushtet nga të cilat premtimet varen, plotësohen në thelb, që do të thotë, kur premtimi bëhet i pakushtëzuar.
93.	Një premtim i kushtëzuar për të dhënë konsiderohet i pakushtëzuar nëse mundësia që kushti të mos plotësohet është e vogël. P.sh, një marrëveshje mes palëve se nga përfituesi duhet hartuar një raport vjetor i detyrueshëm për rimbursimin e pjesës tjetër të fondeve, sipas një premtimi shumëvjeçar, nuk është marrëveshje me kusht nëse mundësia e mos plotësimit të kësaj kërkesë administrative është e vogël. Një transferim i aktiveve, me një premtim të kushtëzuar për të kontribuar, do të kontabilizohet si një paradhënie e kthyeshme derisa kushti të jetë plotësuar për pjesën më thelbësore të tij.
94.	Përcaktimi nëse një premtim është i kushtëzuar apo jo mund të jetë i vështirë nëse përmban marrëveshje të donatorëve që nuk qartësojnë nëse e drejta për të marrë pagesat apo aktivet e premtuara varet nga plotësimi i këtyre marrëveshjeve. Mund të jetë e vështirë të përcaktohet nëse këto marrëveshje janë kushte apo kufizime. Në rastet e marrëveshjeve të paqarta të donatorëve, një premtim që përmban marrëveshje që nuk janë qartësisht të pakushtëzuara, do të trajtohet si një premtim i kushtëzuar.
Shënime shpjeguese për premtimet për të dhënë	
95.	Përfituesit e premtimeve të pakushtëzuara për të dhënë duhet të paraqesin në shënime shpjeguese sa më poshtë: a) Shumat e premtimeve të arkëtueshme në më pak se një vit, nga një në pesë vjet dhe në premtimet me mbi 5 vjet; b) Shuma e lejuar për premtimet e arkëtueshme të pambledhshme;
96.	Përfituesit e premtimeve të kushtëzuara për të dhënë duhet të paraqesin në shënime shpjeguese sa më poshtë: a) Shumën totale të premtuar b) Një përshkrim dhe shumën për çdo grup premtimesh që kanë karakteristika të ngjashme, si p.sh, shumat e premtimeve të kushtëzuara nga hartimi i programeve të reja, përfundimi i ndërtimit të një ndërtese të re dhe mbledhjen e dhurimeve për një ditë (datë) të caktuar.
Paraqitja e pasqyrave financiare dhe shënime shpjeguese për koleksionet	
97.	Një OJF që nuk njih dhe kapitalizon koleksionet e saj do të paraqesë sa më poshtë në pasqyrën e aktiviteteve, të ndarë veçmas nga të ardhurat, shpenzimet, fitimet dhe humbjet: a) Koston e zërave të blerë të koleksionit si një pakësim në klasën e duhur të aktiveve neto; b) Arkëtimet nga shitja e zërave të koleksionit si një rritje në klasën e duhur të aktiveve neto; c) Arkëtimet nga siguracionet në rast humbje apo dëmtimi të zërave të koleksionit, si një rritje në klasën e duhur të aktiveve neto.
98.	Në mënyrë të ngjashme, një OJF që kapitalizon koleksionet e saj në mënyrë prospektive do të paraqesë arkëtimet nga shitja dhe siguracionet e zërave të koleksionit të pakapitalizuara më parë, të ndara veçmas nga të ardhurat, shpenzimet, fitimet dhe humbjet.
99.	Një OJF që nuk njih dhe kapitalizon koleksionet e saj ose që i kapitalizon ato në mënyrë prospektive, do të përshkruajë për koleksionet e saj politikën kontabël dhe mënyrën e administrimit, përfshirë rëndësinë e tyre. Nëse zërat e pakapitalizuar të koleksionit nuk përdoren gjatë periudhës, OJF-ja gjithashtu: a) do të përshkruajë zërat e koleksionit të dhëna tek të tjerë, dëmtuar, shkatërruar, humbur apo mospërdorime të tjera gjatë periudhës, ose b) përshkrimin e vlerës së drejtë të tyre.
100.	Në pasqyrën e pozicionit financiar duhet treguar në një rresht të veçantë se me cilin prej shënimeve në pasqyrën e shënimeve shpjeguese lidhet ky grup i zërave të koleksionit. Në këtë rresht shënohet data nëse koleksionet kapitalizohen në mënyrë prospektive, p.sh, “Koleksione të siguruara që prej 1 Janarit, 20XX



	(Shënimi X).”	
	Data efektive dhe dispozita kalimtare	
101.	Ky Standard do të jetë efektiv për pasqyrat financiare të OJF-ve, të hartuara për periudha raportuese që fillojnë pas datës 01 janar 2016. Zbatimi i këtij standardi do të bëhet në prospektivë.	
102.	Tabela tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me paragrafët e SKK-ve të përmirësuara. Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti që përshkrimet në standardet e referuara mund të kenë ndryshim.	
	Paragrafët sipas SKK OJF	Paragrafët sipas SKK të përmirësuara
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Asnjë
	Paragrafi 5	SKK1, pg 5
	Paragrafi 6	SKK1, pg 6
	Paragrafi 7	SKK1, pg 7
	Paragrafi 8	SKK1, pg 8
	Paragrafi 9	SKK1, pg 96
	Paragrafi 10	SKK1, pg 97
	Paragrafi 11	SKK1, pg 9
	Paragrafi 12	SKK1, pg 10
	Paragrafi 13	Asnjë
	Paragrafi 14	SKK1, pg 11
	Paragrafi 15	SKK1, pg 12
	Paragrafi 16	SKK1, pg 13
	Paragrafi 17	SKK1, pg 14
	Paragrafi 18	SKK1, pg 22
	Paragrafi 19	Asnjë
	Paragrafi 20	Asnjë
	Paragrafi 21	Asnjë
	Paragrafi 22	Asnjë
	Paragrafi 23	SKK1, pg 30
	Paragrafi 24	SKK1, pg 33
	Paragrafët 25 - 102	Asnjë

Shtojca 1

Njësia Jofitimprurëse A
Pasqyra e pozicionit financiar
31 dhjetor 20X1

	20X1	20X0
AKTIVET		
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre		
Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm		
Kontribute të arkëtueshme		
Inventarë dhe shpenzime të parapaguara		
Investime financiare afat gjata		
Aktive të kufizuara për investime në toka, ndërtesa dhe pajisje		
Toka, ndërtesa dhe pajisje		
Investime të tjera afat gjata		
Totali i aktiveve		



DETYRIMET		
Të pagueshme		
Dëftesa të pagueshme		
Kontribute të marra në avancë		
Grante		
Premtime të kushtëzuara për të dhënë		
Hua afatgjatë		
Totali i detyrimeve		
AKTIVET NETO		
Të kufizuara		
a) Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten		
b) Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash		
Të pakufizuara		
Totali i aktiveve neto		

Shtojca 2

Njësia jofitimprurëse A
Pasqyra e aktiviteteve (performancës)
31 dhjetor 20XI
(Shpenzimet të paraqitura sipas funksionit)

Përshkrimi i zërit	20X1	20X0
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:		
Të ardhurat:		
Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit		
Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare		
Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit		
Të ardhura nga investimet apo dhurimet		
Tarifat për shërbimet		
Të ardhura nga aktivitetet tregtare		
Të ardhura të tjera		
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara		
Aktive neto të çliruara nga kufizimet:		
Realizimi i kufizimeve të programit		
Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve		
Përfundimi i kufizimit të afatit		
Totali i aktiveve neto të çliruara nga kufizimet		
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:		
Shpenzime për aktivitetet		
Aktiviteti A		



Aktiviteti B		
Aktiviteti C		
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme		
Krijim dhe rritje fondesh		
Totali i shpenzimeve		
Rritja/rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)		
Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:		
Kontributet		
Të ardhurat nga investimet afat gjata		
Fitimi i realizuar dhe i porealizuar nga investimet afatgjata		
Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		
Aktivitet neto të çliruara nga kufizimet (me shenjë minus)		
Rritja/rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)		
<i>Ndryshimi në aktivet neto (A + B)</i>		
Aktive neto në fillim të vitit		
Aktive neto në fund të vitit		

Shtojca 3

Njësia jofitimprurëse A
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare
31 dhjetor 20X1
Metoda direkte

Përshkrimi i zërave	20X1	20X0
Flukset nga aktivitetet e shfrytëzimit		
Para të arkëtuara nga kontribute të pakufizuara		
Para të arkëtuara nga përfituesit e shërbimeve		
Grante i pagueshëm / kthyeshëm		
Të paguara për punonjësit dhe furnitorët		
Interes i paguar		
Interes dhe dividendë të arkëtuar		
Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		
Flukset nga aktivitetet investuese		
Kontribute të kufizuara		
Blerje/shitje investimesh		
Blerje/shitje të aktiveve afatgjata materiale		
Flukse neto nga aktivitetet investuese		
Flukse nga aktivitetet financuese		
Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
Interesa dhe dividendë të kufizuar për qëllime në terma afatgjatë		
Principal i paguar për dëftesat e pagueshme		
Flukse neto nga aktivitetet financuese		
Rritje / rënie neto e flukseve		
Gjendje në fillim të periudhës		
Gjendje në fund të periudhës		



Shtojca 3

Njësia jofitimprurëse A
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare
31 dhjetor 20XI
Metoda indirekte

AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT		20X1	20X0
Ndryshimet në aktivet neto			
Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me flukset neto nga aktivitetet e shfrytëzimit:			
	Amortizimi dhe zhvlerësimi		
	Humbjet e realizuara dhe të porealizuara në investime		
	Humbjet nga dalja jashtë përdorimit e makineri pajisjeve		
	Kontributet jo në para		
	Rritjet / rëniet jo në para të inventarëve		
	Kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:			
	Të tjera të arkëtueshme		
	Shpenzime të parapaguara		
	Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme		
	Të pagueshme		
	Bamirësi mbi baza vjetore		
Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit			
AKTIVITETET INVESTUESE			
	Blerje / shitje investimesh		
	Blerje / shitje e Aktiveve afatgjata		
	Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme		
	Të arkëtuara në avancë nga dëftesa të arkëtueshme		
Flukse neto nga aktivitetet investuese			
AKTIVITETET FINANCUESE			
	Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
	Principal i paguar për dëftesat e pagueshme		
Flukse neto nga aktivitetet financuese			
Rritje / rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës			
Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa			
Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për tatim taksa			



VENDIM

Nr. 59, datë 14.9.2015

**PËR PLANIN E NDIHMËS
SHTETËRORE PËR RINDËRTIMIN E
STADIUMIT “LORO BORIÇI” SHKODËR**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtar
Dareka Dariu	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 14/09/2015, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, ka marrë në shqyrtim planin e ndihmës shtetërore “Për financimin e rindërtimit të stadiumit “Loro Boriçi”, të njoftuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 5075/1, datë 13.8.2015.

I. Procedura

1. Në zbatim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 5075/1, datë 13.08.2015 ka njoftuar pranë MZHETTS, në cilësinë e dhënësit të ndihmës, planin e ndihmës shtetërore “Për financimin e rindërtimit të stadiumit “Loro Boriçi”.

2. Drejtoria e Tregut të Brendshëm në MZHETTS, me shkresën nr. 6440/1, datë 7.9.2015, konfirmoi regjistrimin e ndihmës së njoftuar në Regjistrin e Ndihmave Shtetërore.

II. Përshkrimi i planit të ndihmës shtetërore

3. Plani i ndihmës ka si qëllim financimin e projektit për rikonstrukcionin e stadiumit “Loro Boriçi”, në përputhje me kërkesat e UEFA-s. Ky plan do të ndikojë në plotësimin e kushteve infrastrukturore sportive, sipas standardeve evropiane, si edhe në zhvillimin social të qytetit të Shkodrës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme.

4. Vlera e plotë e investimit për këtë objekt është përlogaritur të jetë 2, 445 003 076 lekë. Dhënësi i ndihmës ka kërkuar miratimin ndihmës në shumën 1 500 000 000 lekë, si fonde grand për federatat sportive.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

5. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, mbështetja me grante nga buxheti i shtetit përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet: a) aktivizohen burime shtetërore; b) jepet një avantazh ekonomik; dhe c) ndikim në konkurrencë.

6. Rindërtimi i stadiumit “Loro Boriçi” do të financohet me fonde nga buxheti i shtetit. Financimi i këtij projekti mund të përbëjë ndihmë shtetërore, nëse është selektive dhe jepet për kryerjen e një aktiviteti të caktuar ekonomik¹. Veprimtaria ekonomike duke përdorur infrastrukturën e Stadiumit në Shkodër do të përfitojë burime shtetërore².

7. Në stadiumin e rindërtuar “Loro Boriçi”, do të kryhen edhe shërbime tregtare. Ofrimi i një objekti sportiv publik, kundrejt pagesës, përbën një aktivitet ekonomik. Kostot e investimit të nevojshme për kryerjen e këtij aktiviteti ekonomik nuk janë të mbuluara me të ardhurat e veprimtarisë në fjalë, por me burime shtetërore. Prandaj, aktivitetet ekonomike që do të zhvillohen në këtë stadium përfitojnë një avantazh, i cili nuk do të ishte ofruar në një situatë normale të tregut.

8. Në lidhje me një efekt të mundshëm në tregti dhe konkurrencë në tregun e brendshëm, shfrytëzimi i objekteve sportive do të kryhet nga organizatorë të veprimtarive sportive dhe ndërmarrjeve vendase me objekte të ndryshme të veprimtarisë së tyre ekonomike, me një ndikim të vogël në konkurrencë³.

Konkluzion mbi ekzistencën e ndihmës shtetërore

9. Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, në kuptim të nenit⁴ të ligjit për ndihmën shtetërore, Komisioni i Ndihmës Shtetërore arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që i bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, përbën ndihmë shtetërore.

IV. Ligjshmëria e ndihmës

10. Dhënia e ndihmës është objekt i miratimit të

¹ State aid S.A.37109 (2013/N) – Belgium Football stadiums in Flanders

² State aid S.A.35440 (2012/N) – Germany Multifunktionsarena der Stadt Jena

³ S.A.31722 – Hungary Supporting the Hungarian sport sector via tax benefit scheme



Komisionit të Ndhmës Shtetërore. Për këtë arsye, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përmbushur detyrimin në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 20, pika 3, dhe nenin 13 “ndihma shtetërore që mund të lejohet”, duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nga ana e Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

V. Përputhshmëria me nenin 13 (3) të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar

11. Objektivi kryesor i ndihmës është:

Rindërtimi i stadiumit “Loro Boriçi” në Shkodër për organizimin e ri të ambienteve të brendshme të godinës ekzistuese, duke ofruar shërbimet e nevojshme për median, personat me aftësi të kufizuara në harmoni me të gjitha kërkesat e parashtruara nga UEFA, si edhe standardet evropiane.

Komisioni konsideron se vlerësimi i përputhshmërisë së masës duhet të bazohet në mënyrë të drejtpërdrejt në nenin 13, pika 3 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2014, “Për ndihmën shtetërore”, i cili parashikon se ndihma mund të lejohet nëse “lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.

12. Dhënësi i ndihmës raporton se masa ka për qëllim realizimin e një investimi madhore, me ndikim të konsiderueshëm jo vetëm në cilësinë e sportit shqiptare, por edhe të komunitetit, veçanërisht në qytetin e Shkodrës. Institucionet ndërkombëtare, FIFA-s dhe UEFA-s, kanë përcaktuar si kusht domosdoshmërinë e ndërtimit të një stadiumi modern, që plotëson kushtet edhe standardet e kërkuara prej tyre. Rindërtimi konsiston në organizimin e ri të ambienteve të brendshme të godinës ekzistuese, duke ofruar shërbimet e nevojshme edhe për median.

13. Për rrjedhim, masa e ndihmës shtetërore mbështet realizimin e një projekti madhore dhe me impakt të konsiderueshëm, jo vetëm në cilësinë e sportit shqiptare, por edhe në zhvillimin e

veprimtarive të caktuara ekonomike në qytetin e Shkodrës.

VI. Konkluzione

14. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se plani i ndihmës për rindërtimin e stadiumit “Loro Boriçi”, lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike, si edhe zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike dhe për këtë arsye është në përputhje me nenin 13, pika 3 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 17, 20 (pika 3), 24, 25, 29, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore për rindërtimin e stadiumit “Loro Boriçi” Shkodër në shumën 1 500 000 000 lekë, mbështetur në nenin 13, pika 3 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse skema mbështet realizimin e një projekti të rëndësishëm dhe me ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e sportit shqiptare si edhe lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike .

2. Aksesit në infrastrukturën e stadiumit “Loro Boriçi” duhet të jetë i hapur për disa përdorues, duke respektuar parimin e transparencës dhe mosdiskriminimit. Nëse objektet sportive do të përdoren nga disa organizatorë të veprimtarisë apo shfrytëzues të objektit sportiv, atëherë mënyra e pagesës për përdorimin e tyre duhet të bëhen publike.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 238 lekë